



• ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER
SHTATOR 2006, Nr. 24



Reformat në Kuvend

EDITORIAL

*Debati për kushtetutën e Kosovës*

Gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm do të merren vendime të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Negociatat e Vjenës për çështjet si reformimi i pushtetit lokal, të drejtat e komuniteteve pakicë dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, që po zhvillohen nën drejtimin e Presidentit Ahtisari, përbëjnë fazën vendimtare të procesit, ndonëse ende nuk ka shenja që së shpejti do të arrihet ndonjë marrëveshjeje. Ndërkohë, pritet që Grupi i Kontaktit dhe Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara të debatojnë rreth Kosovës dhe të përcaktojnë afatet kohore për marrjen e vendimit për statusin e ardhshëm të Kosovës, që sipas të gjitha gjasave do të jetë fundi i vitit.

Në Kosovë tanimë kanë filluar edhe konsultimet rreth hartimit të kushtetutës së re të Kosovës. Përfundimi i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit do të thotë në të njëjtën kohë se edhe dokumenti që pritet të zëvendësojë Kornizën Kushtetuese duhet të miratohet, duke u mbështetur në marrëveshjen për zgjidhjen e statusit të ardhshëm lidhur me çështjet e diskutuara në bisedimet e Vjenës. Pa dyshim se Kuvendi i Kosovës do të luajë një rol vendimtar gjatë procesit kushtetues, ngase ofron një forum legjitim për diskutime gjithëpërfshirëse dhe transparente dhe të vendimmarrjes. Fundja, kështu është në të gjitha shoqëritë demokratike.

Për shkak të bisedave rreth statusit dhe procesit kushtetues, jo vetëm institucionet e Kosovës, por edhe shoqëria e saj janë duke u përgatitur për ndryshime të thella. Kjo është një ndër sfidat më të mëdha me të cilat është ndeshur Kosova gjer më tani. Ngase menjëherë pas vendimit për statusin, brenda një kohe shumë të shkurtër, institucionet e Kosovës do të duhet të dëshmojnë pjekurinë dhe vizionin e tyre me rastin e hartimit dhe miratimit të kushtetutës. Përpos kësaj, kjo periudhë përbën një mundësi mjaft të mirë për të gjitha komunitetet që t'i afrohen njëra tjetrës dhe të bashkëpunojnë për krijimin e një të ardhme më të mirë. Të shpresojmë se kjo mundësi do të shfrytëzohet me mençuri dhe se do t'i vë themelet e një marrëveshjeje të qëndrueshme midis komuniteteve në Kosovë.

Në epiqendër të vëmendjes së këtij edicioni të Buletinit Informativ ASI janë zhvillimet kryesore në Kuvendin e Kosovës siç janë pakoja për reformat në Kuvend, themelimi i Agjencionit Anti-Korrupsion dhe hartimi i vizionit evropian për Kosovën. Njëherësh, në këtë edicion hapet edhe një kapitull të veçantë, ajo e debatit kushtetues në Kosovë, i cili do të fokusohet, në mënyrë politike dhe akademike, në aspekte të rëndësishme të rregullimit të ri kushtetues. Së këndejmi, ftohen juristët dhe akademikët, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe qytetarët që të gjithë ta japin kontributin e tyre në këtë debat kaq të rëndësishëm.

*Franklin De Vrieze,
Koordinator i Iniciativës për Përkrahjen e Kuvendit.*

Editorial	2
Katër muajt e mi të parë në krye të Kuvendit të Kosovës	3
Momenti vendimtar për Kosovën po afrohet	5
Reforma në punën e Kuvendit – qëllimi dhe efektet	6
Përmirësimi i praktikave parlamentare	8
Përgjegjësia e qeverisë ndaj kuvendit	9
Mbështetja e Kuvendit të Kosovës nga katër parlamentet kryesore të Evropës	11
Programi i vitit 2006 për mbështetje të negociatave	12
Shkëmbimi i përvojave me fqinjët	13
Integrimi evropian ecën me hapa të shpejtë	14
Tryeza e rrumbullakët për hartimin e kushtetutës së re ndihmon në promovimin e vlerave demokratike në Kosovë	16
Zhvillimet e kohëve të fundit në Kuvend	18
OInstitucioni i Ombudspersonit publikon raportin e gjatë vjetor (2005-2006))	20
Zgjedhjet po afrohen	21
Praktikantët e OSBE-së organizojnë konferenca për grupet parlamentare në lidhje me çështjet e politikave	23




“Katër muajt e mi të parë në krye të Kuvendit të Kosovës”

Nga Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit të Kosovës

Katër muajt e punës sime në krye të Kuvendit të Kosovës koiciduan me njëqindtëshin e punës së Qeverisë Çeku. Kur Kryeminsitri erdhi në Kuvend për të raportuar punën e Qeverisë, ndonëse nuk ma kërkoi askush, disi spontanisht mendova që të paraqes vetë një lloj raporti për punën që është bërë gjatë kohës prej kur jam kryetar i Kuvendit të Kosovës. Këtë e ndjeva si përgjegjësi në bazë të parimit të llogaridhënies, por edhe më shumë si obligim për shkak të punës që kemi bërë tërë këto ditë. E ndjeva si obligim për punën e kolëgevë të mirë, punë e stafit dhe partnerëve ndërkombëtarë të cilët na ofruan ndihmesë kolosale. Dhe jo vetëm për punën por edhe për rezultatet. Prandaj ftova mediat dhe i bëra publike rezultatet e punës dhe ju ofrova shansin që të pyesin për çdo gjë.

Katër muajt e fundit në Kuvendin e Kosovës është bërë një progres shumë i rëndësishëm. Hapat dhe projektet e miratuara gjatë kësaj kohe janë ndër ato veprime që mbahen mend sepse mundësojnë strukturimin efikas të Kuvendit të Kosovës në rrugën e synimeve për realizimin e rolit të rëndësishëm të Kuvendit në këtë fazë të proceseve në Kosovë.

Që në ditën e parë të ardhjes sime në timonin e Kuvendit e bëra të qartë dhe për çdo ditë jam munduar të bëj diçka në respektimin e dinjitetit të deputetit. Kemi bërë diçka dhe



Kolë Berisha

mendoj se ende e vazhdimisht duhet të bëjmë sepse deputetet janë personifikim, përfaqësues të popullit. Në këtë kuadër e kemi bërë të qartë sa I japim rëndësi dinjitetit të figurës së deputetit, përmes respektimit të mendimit të tij, fjalës së tij, sepse fjala e hapur është sinonim, palcë kurrizore e një parlamenti demokratik. Jemi betuar se nuk do të ketë mikrofonat të mbyllur por do ti përdorim me rend dhe në bazë të rregullave që I kemi miratuar bashkërisht.

Gjatë kësaj kohe kemi arritur të realizojmë projektin e reformës dhe planin e standardeve. Projekti përmban kalendarin vjetor të punës së Kuvendit, Kryesisë, Grupeve Parlamentare dhe të

komsioneve. Këtu hyjnë interpellancat e rregullta, seancat e obligueshme (50 minutëshe) të pyetje-përgjigjeve, ristrukturim i administratës, sistemit informative, qasje e mediave dhe publikut në dokumenta dhe në punën e Kuvendit. Mediave ua bëra të qartë interesim të ndërtojmë partneritet. I ftova që të jenë më shumë në Parlament dhe afër Parlamenti ku tashmë nuk ka e nuk do të ketë asnjë sekret për media.

Pra janë veprime që dëshmojnë se do të ketë plan në punën tonë e jo stih. Plan e përgatitje për çdo gjë edhe për rendin e ditës në mënyrë që seancat të merren me çështje thelbësore e jo me çështje teknike. Kemi bërë diçka të

mirë për këtë legjislacion por na gëzon fakti se kjo praktikë do të mund të përdoret si model funksional edhe nga legjislaturat e ardhshme. Ne e kemi marrë nga praktikat e disa parlamenteve më të avancuara euro-perëndimore, të dëshmuara për rezultat në punën parlamentare. Janë veprime për të cilat shpesh kemi konstatuar me keqardhje se nuk i kemi në praktikën tonë siç bëjnë parlamentet e tjera. Pra tani I kemi edhe ne dhe po i përdorim dhe jemi optimist se do të jëne rezultative. Mjafton të përmendim këtu vetëm pjesën e pyetje-përgjigjeve të cilat do t'i kemi tani e tutje në fillim të çdo seance të parlamentit. Opozita ka shansin të thotë fjalën e vetë për çdo gjë ndërsa

ministrat nuk kanë pse të friksohen nga kjo. Nëse kanë përgjigje të mira, përgjigje të forta nderojnë veteveten, qeverinë, partinë e vetë dhe shtojnë kredibilitetin e tyre. Nëse punojnë, nëse kanë rezultate ky është shans që të tregohet puna e tyre. Nëse nuk kanë përgjigje le të kuptojnë se nuk janë në nivelin e përgjegjësive. Pra kemi vënë një lloj prozhektori në Kuvend ku askush nuk mund të fshihet – do të dihet e do të shihet mirë edhe puna edhe mospuna e secilit. Kjo është në interes të demokracisë, kjo është në interes të Kosovës.

Me këto reforma në përgjithësi e veçanërisht me sistemin e pyetje-përgjigjeve është instaluar një model që dinamizon procesin dhe punën e kuvendit.

Kjo tregon se tashmë ka filluar të zbatohet koncepti i menduar për dinamizim të punës, për transparencë,

ngritje të përgjegjësive të cilat bëjnë hapin vendimtar në realizimin e rolit demokratik të parlamentit dhe garantojnë kontroll demokratik mbi punën e Qeverisë, si një nga funksionet kryesore që kërkohet nga parlamenti.

Ne natyrisht se krenohemi me këto suksese, ndërsa vlerësimi për këto të mbërime nuk është vetëm yni. Vlerësime të larta për këto ndryshime pozitive, siç e dini, na kanë ardhur nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan, nga OSBE, nga Parlamenti Evropian, nga zyrtar diplomatike në Kosovë, monitoruesit dhe mbështetësit ndërkombëtar të punës së Kuvendit të Kosovës. Këto vlerësime për ne janë shumë domethënëse dhe inspiruese për punë të mëtejme.

Gjatë kësaj kohe kemi bërë të qartë sa shumë rëndësi i japim bashkëpunimit ndërkombëtarë të Kuvendit. Me disa vizita në Shqipëri, SHBA,

Greqi e Maqedoni si dhe takime pothuaj të përditshme me diplomat ndërkombëtarë në Prishtinë kam shpjeguar punën që po bëhet në Parlamentin e ri të Kosovës, sfidat me të cilat ndeshemi. Në takimet e mia dhe të kolegëve të mi kemi demonstruar gatishmërinë e bashkëpunimit me parlamentet e tjera sidomos me ato të rajonit, pastaj kemi shpjeguar çfarë është vullneti i popullit të Kosovës për status dhe premtimet tona për të ardhmen e Kosovës si shtet të qytetarëve të barabartë, me prosperitet dhe garanci kushtetuese për të gjitha liritë dhe të drejtat e minoriteteve.

Ne ndihemi mirë për këto hapa dhe suksese sepse në vetvete përmbajnë edhe pjesën e standardeve që na janë kërkuar nga miqtë tanë ndërkombëtarë dhe që lidhet ngushtë me çështje të statusit, qoftë kur është fjala për ligje të kërkuara nga Grupi i Kontaktit apo për standardin demokratik

në funksionimin e brendshëm të Kuvendit. Në këtë mënyrë Kuvendi ka dhënë shembullin e vete, kontributin për statusin e Kosovës. Natyrisht se jemi të përgatitur dhe në mobilizim të vazhdueshëm për pjesën tjetër edhe më të rëndësishme të rolit që ka Kuvendi në firmosjen dhe vulosjen e projektit të pavarësisë së Kosovës sipas vullnetit të popullit të Kosovës.

Natyrisht se kemi ende dobësi e sfida të cilat na japin rastin për t'i tejkaluar. Por rezultatet e katër muajve të fundit janë pozitive edhe për faktin se paraqesin bazën solide, ndërtimin e një strukture që do të mundësojë edhe avancim të mëtejme të rezultateve dhe sukseseve të Kuvendit të Kosovës i cili ka rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për zhvillimin e proceseve demokratike, për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës

Prishtinë, më 28.07.2006



Momenti vendimtar për Kosovën po afrohet

Doris Pak, anëtare e Parlamentit Evropian



Sfidat e negociatave për statusin final të Kosovës janë të pamohueshme... Dhe përkundër faktorëve që ndikojnë pozitivisht në zgjidhjen e statusit siç janë tranzicionin i qetë pas Rugovës (për të cilën më së shumti merita ka klasa politike e Kosovës), përpjekjeve të Kryeministrit të ri për shtimin e angazhimit dhe përpjekjeve të qeverisë rreth përmirësimit të pozitës së minoriteteve, si dhe raportit mjaft pozitiv që kohëve të fundit ka prezantuar UNMIK-u në Këshillin e Sigurimit, megjithatë ende mbetet punë për të bërë në mënyrë që popullit t'i ofrohen zgjidhje për problemet që mund të dalin menjëherë pas zgjidhjes së statusit.

S'do mend se tani është vështirë që të bisedohet për tema dhe çështje që kanë të bëjnë me BE-në, siç janë Agjenda e Selanikut dhe Procesi i Stabilizim Asocimit, në një kohë kur: Statusi i ardhshëm i Kosovës është çështja dhe preokupimi i vetëm i komisionit parlamentar për çështje evropiane

Çështjet si izolimi i serbëve të Kosovës, ndarja serbëve në mes atyre që jetojnë në Veri dhe nëpër enklava, si dhe shqetësimet për sigurinë dhe mospjesëmarrjen e serbëve në

institucionet e përkohshme duhet të merren parasysh dhe shqyrtohen në mënyrë të mirëfilltë me rastin e hartimit të kushtetutës së re për Kosovën. Ligji për të drejtat e minoriteteve tanimë është duke u hartuar, gjë për të cilën Kryetari i Parlamentit të Kosovës është shumë krenar.

Serbët e Kosovës përfaqësohet nga disa parti politike, dhe ndonëse njëra nga to është më kryesorja (Lista serbe për Kosovë dhe Metohi), megjithëkëtë zëri i serbëve të Kosovës nuk dëgjohet në bisedimet për status, ngase qëndrimet dhe interesat e tyre i "përfaqëson" vetëm Beogradi. Së këndejmi, parlamentarët serbë të Kosovës hamendësohen dhe nuk mund të vendosin nga të orientohen politikisht. Zëvendës PSSP-ja z. Stiven Shuk gjatë një takimi të zhvilluar kohëve të fundit ka bërë të ditur se është shumë e vështirë të merresh vesh me Beogradin, ngaqë ata përqendrohen vetëm në temat dhe çështjet që kanë të bëjnë me jetën e përditshme të serbëve të Kosovës dhe jo në Agjendën politike të definimit të statusit.

Nga ana tjetër, Qeveria e Kosovës duket të jetë mjaft e "relaksuar" lidhur me këtë çështje meqë konsideron se është mjaft konstruktive jo vetëm sa i takon jetësimit të standardeve në vend, por edhe në tryezën e bisedimeve, që ka për qëllim arritjen e progresit në fusha të ndryshme; dukej se ata janë të bindur se nuk kanë nevojë të bisedojnë fare me Serbinë, por vetëm me bashkësinë ndërkombëtare, ngase ata besojnë se kjo e fundit është në anën e tyre

dhe e gatshme t'u japë një lloj "sovrانيتeti të kufizuar", një zgjidhje që duket të jetë më e pranueshme për palën kosovare se sa "pavarësi e kushtëzuar".

Veç këtyre, ata pohojnë se Kosovës do t'i nevojitet BE-ja për ta mbështetur dhe ndihmuar atë gjatë fazës pas statusit, por se BE-ja, sipas tyre, nuk do të duhej të kishte kompetenca ekzekutive dhe në administrim të drejtpërdrejt. Njëherësh, ata kanë shprehur bindjen e tyre se KFOR-i duhet të mbetet në Kosovë, ndërkaq Trupat Mbrotjtëse të Kosovës duhet të reformohen. Pajtohem.

Duke qenë se i kam ndjekur me vëmendje zhvillimet si në Kosovë ashtu edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor për shumë vite, unë, si parlamentarë, jam e interesuar në mënyrë të veçantë për rolin që ka dhe mund të ketë Kuvendi i Kosovës në të ardhmen e afërt, dhe për mënyrën e si mund të përmirësohet performansa e tij.

Kujtoj se Parlamenti i Kosovës duhet t'i marrë të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë që i takojnë e të cilat akoma nuk i ka marrë. S'do mend se asistencë parlamentare duhet të rritet dhe profesionalizohet dhe për këtë tanimë ekzistojnë projekte të ndryshme të hartuara nga OSBE-ja në bashkëpunim me vende të tjera në nivel bilateral, dhe unë krenohem për faktin se nisma dhe lansimi i këtyre projekteve ka ardhur nga vendet e BE-së. Mirëpo, parlamentarët duhet të mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për shndërrimin e, së paku, institucionit të tyre në një institucion të

demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Ndërkaq, duke mbajtur parasysh situatën aktuale në Kosovë, konkretizimi i këtyre nismave duhet të zhvillohet në tri drejtime kryesore: Integrimi evropian, mbikëqyrja e veprimtarisë së qeverisë dhe e respektimi i të drejtave të njeriut dhe pakicave.

Integrimi evropian është një perspektivë dhe rast tejet i rëndësishëm dhe madje unik për perspektivën e Kosovës, pavarësisht se a mbetet pa u zgjidhur statusi i Kosovës: Parlamenti, dhe mbi të gjitha komisioni përkatës i tij, duhet të impenjohet më tepër dhe të jetë më i përgjegjshëm në promovimin e programit legjislativ të punës me qëllim të përgatitjeve për integritet evropian; kjo do të kërkonte, pa dyshim, një përqendrim edhe në çështje ekonomike dhe teknike, të cilat do të jenë më pak atraktive se sa çështja e pavarësisë së Kosovës, por që megjithatë janë çështje të domosdoshme. Së këtejmi, organet e Parlamentit duhet që po ashtu, në këtë kontekst, të punojnë së toku me parlamentet e tjera të rajonit në forume relevante, dhe njëherësh t'i thellojnë më tej marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare dhe multilaterale, duke i intensifikuar në radhë të parë marrëdhëniet me Parlamentin Evropian.

Mbikëqyrja e punës së qeverisë është një nga detyrat kryesore të çdo Parlamenti demokratik: Parlamenti i Kosovës duhet të ketë një rol më dinamik sa i takon mbikëqyrjes së punës së qeverisë posaçërisht në fushat si sundimi i ligjit, luftimi

i krimin dhe korrupsionit, hartimi i politikave për zhvillimin e ekonomisë si dhe implementimi i standardeve. Pa dyshim se, në këtë kontekst, në mënyrë të veçantë duhet të monitorohen sigurimi i shërbimeve elementare për të gjitha komunitetet në Kosovë, siç janë kujdesi shëndetësor, shkollat dhe shërbimet komunale.

Një ndër çështjet pothuajse më të rëndësishme në Kosovë, është se Parlamenti duhet të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin e demokracisë dhe të drejtave: Lidhur me këtë gjëja e parë që më vëndmend është hartimi apo përcaktimi i rregullave më të përshtatshme në Parlament me qëllim që të bëhet e mundur që përfaqësuesit e minoriteteve t'i ushtrojnë në tërësi të gjitha të drejtat dhe prerogativat e tyre. Fjala vjen, sigurimi i pajisjeve për përkthim do të ishte një ndihmesë e madhe në këtë drejtim. Ndërkaq, sa i takon çështjeve përmbajtësore, Parlamenti i Kosovës duhet të jetë mbrojtësi dhe avokati më i mirë dhe më aktiv i çështjeve si kthimi i pronave, politikave të qëndrueshme për kthim, mbrojtja e të drejtave elementare njerëzore, dhe politikave arsimore.

Pikërisht për arsye se dëshiroj ta vazhdoj përkrahjen time për kolegët e mi nga Kosova në rrugën e tyre drejt përcaktimit të statusit përfundimtar, e kam për obligim që të përsëris edhe një herë se për realizimin e një shoqërie demokratike dhe multietnike në Kosovë ata kanë ende rrugë për të bërë dhe se është në interesin e tyre që të impenjohen edhe më tepër drejt arritjes së këtij synimi madhor.

*Sarbrücken-Bruksel, 18 korrik
2006*

Reforma në punën e Kuvendit – qëllimi dhe efektet

Ramë Manaj, Këshilltar politik e ligjor i Kryetarit të Kuvendit

Kuvendi, organi më i lartë përfaqësues e ligdhënës i çdo shteti, është vendi ku kultivohet e zhvillohet dhe prej nga reflektohet demokracia. Parlamenti i Kosovës, ndonëse i ri për nga mosha, imbeshtetur mbi vullnetin përcaktues të popullit, në punën e tij tanimë mbi pesëvjeçare vazhdimisht po bën përpjekje që të shndërrohet në log të debatit dhe vendosjes demokratike. Megjithatë, erdhi një moment kur puna e rëndësishme e fillimit mund të humbte në peshë nëse nuk do të kishte një frymë të re inventive, hapa të ri të ristrukturimit efikas në punën e këtij institucioni të rëndësishëm të Kosovës. Pra duhej domosdoshmërisht të bëhej një reformë e punës së Kuvendit. Kështu pas një pune të palodhshme të stafit profesional të Kuvendit dhe ekspertëve nga disa organizata ndërkombëtare që me 1 qershor me votë unanime të miratohet projekti i reformes së Kuvendit.

Triaspektet përmbajnë korpusin e synimeve të reformës: demokratizimi, efektiviteti i shtuar dhe transparenca, gjë që do të arriheshin duke shndërruar Parlamentin e Kosovës në tempull të vërtetë të demokracisë parlamentare ku ka liri të shprehjes dhe fjalës, ku deputeti ndjehet subjekt – zot shtëpie dhe jo objekt, ku ndjehet fuqishëm zëri i pozitës dhe opozitës, shumicës dhe pakicës, ku demonstrohen standarde të mirfillta demokratike.

Për planifikimin e arritjes së këtyre tri qëllimeve gjithëpunës i ka paraprirë një konsultim i gjerë mes mbështetësve dhe monitoruesëve të punës së Kuvendit (NDI, OSBE, AER-it etj) me këshilltarët e kryeparlamentarit e që ka rezultuar me Planin e reformimit ose Reformën e punës në kuvend. Kjo Reformë, e cila tashmë ka filluar të jap rezultate të prekshme, bazohet në katër shtyllat e saj:

- I Kalendarin e Seancave plenare, mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të Grupeve parlamentare dhe komisioneve;
- II Një calendar të ngjarjeve, me qëllimin të paralajmërimit të çështjeve më relevante për një periudhë 2-3 mujore e në të cilat duhet fokusuar parlamenti;
- III Një plani të standardeve që paraqet kurrizin e kësaj reforme. Ky plan përfshinë:
 - a) periudha të rregullta për çdo séance plenare të pyetjeve të deputetëve dhe përgjigjeve të ministrave, në kohëzgjatje prej 50 minutash,
 - b) interpelanca të rregullta të grupeve parlamentare,
 - c) mbështetje teknike në punën e komisioneve,
 - d) përmirsim në organizimin dhe punën e administratës,
 - e) project-buxhetin e inicuar

nga Komisioni për buxhet e finansa dhe të miratuar nga Kryesia e Kuvendit,

- f) përmirsim në menagjimin e sistemit informatik,
- g) qasje në dokumente nga mediat dhe publiku si dhe
- h) listen e çështjeve për t'u diskutuar apo strukturën e rendit të ditës dhe statusit të ligjeve dhe

IV Plotësim-ndryshimet e Rregullorës së punës së Kuvendit që mundësojnë implementimin e kësaj reforme

Secili prej elementeve përbërëse të kësaj reforme ka peshën dhe rëndësinë e madhe. Kështu, edhe pse është periudhë e shkurtër e aplikimit të këtyre ndryshimeve në punën e kuvendit, tanimë shihet qartë se pyetjet e rregullta dhe të shumta të deputetëve për Qeverinë, kryeministrin dhe ministrat (në këtë periudhë janë bërë më shumë pyetje se për afër pesë vitet e shkuara) reforma po sjell në praktikë përgjegjësinë e qeverisë para organit legjislativ, kontrollin dhe mbikqyrjen e saj nga ana e Parlamentit, ka dëshmuar gadishmërinë e qeverisë dhe ministrave për këtë formë të demonstrimit të përgjigjesisë, ka ngritur transparençën e punës, efikasitetin por edhe demokratizimin. Tanimë ka filluar të shndërrohet në rutinë mënyra e parashtrimit të pyetjes, njoftimit të ministrit përkatës me pyetjen, me kohën e përgatitjes së tij për përgjigje dhe tani kjo ecën gjithnjë e më

mirë.

Interpelancës, të cilën mund ta ngris çdo grup parlamentar, i është rezervuar kohëzgjatje prej dy orësh për çdo seancë plenare.

Në punën e deritanishme të komisioneve është vërejtë mungesë e mbështetjes teknike, gjë që është fokusuar si domosdoshmri për ndryshim të kësaj gjendjeje. Sepse efikasiteti i punës së komisioneve sidomos në punën e ligjeve, përballë zhvillimeve të kohës është dhe mbetet tepër i rëndësishëm.

Organizimi më adekuat dhe puna më efektive e administratës po e lehtëson

dhe ngrit efikasitetin e përgjithshëm të kuvendit,

Përherë të parë Projekt-buxheti i Kuvendit inicohet dhe përgatitet nga Komisioni për buxhet e finansa i Kuvendit, kështu jo vetëm që plotësohet procedura ligjore por edhe bëhet një planifikim dhe vendosje cilësore që prevenon në masë të konsiderueshme probleme që do të rrjedhnin në vijim të vitit buxhetor.

Tashmë vazhdojnë angazhimet për përmirsim teknike dhe metodologjike në sistemin informatik dhe menagjimin e tij.

Përmirsimet e përmendura në paragrafin e sipërm do të mundëojnë qasje më cilësore

dhe më efektive të mediave dhe qytetarëve në dokumentacion, gjithësi në funksion të transparencës së plotë.

Edhe strukturimi i çështjeve për t'u shqyrtuar e vendosur, qoftë në seancë plenare apo në Kryesinë e Kuvendit, tashmë bëhet në mënyrë më adekuate.

Kështu, ndonëse është përiudhë jo shumë gjatë e jetës së kësaj reforme të vogël, Parlamenti i Kosovës duket qartazi se është më shumë në funksion të tij, është më i relaksuar, merr frymë më demokratike, më transparent dhe padyshim më efektive.

Tashmë janë bërë edhe vle-

rësimet e para pozitive, që vijnë edhe nga vendorët edhe nga ndërkombëtarët dhe kjo është inkurajuese.

Kjo nismë e reformimit do identifikojë edhe më tutje nevojat e përmirsimëve të vazhdueshme të punës së parlamentit dhe organeve të tij.

Një parlament demokratik dhe efektive do të thotë legjislacion kompatibil me synimet zhvillimore dhe integruese të Kosovës, do të thotë stabilitet dhe prosperitet i saj. Prandaj mbetet i domosdoshëm fokusimi në përmirsimet kontinuele të angazhimit dhe punës së Parlamentit.



Përmirësimi i praktikave parlamentare

Nazim Jashari, deputet i Kuvendit të Kosovës, Partia Reformiste "Ora"

Duke qenë se tradita e parlamentarizmit shumëpartiak në vendin tonë ka filluar të zhvillohet pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001, është më se normale që disa shprehje politike të fituara nga parlamentet e mëparshme njëpartiake të vërehen edhe gjatë punës së parlamentit demokratik.

Kjo është vërejtur më shumë gjatë legjislaturës së parë të Kuvendit të Kosovës, por edhe në legjislaturën e dytë një manifestim i tillë ka vazhduar, sidomos para shkarkimit të kreut të deriatëhershëm të kuvendit, në mars të këtij viti.

Gjatë punës së vet në seanca plenare, Kuvendi i Kosovës ia ka dalë t'i miratojë një sërë ligjesh, të inicuar kryesisht nga Qeveria e Kosovës, ndërsa rastet kur ligjet janë iniciuar nga propozues të tjerë janë tepër të rralla, gati simbolike.

Projektligjet e shqyrtuara dhe të miratuara në të

shumtën e rasteve kanë qenë pa ndonjë prioritet të qartë. Nuk është bërë përpjekje që duke propozuar një pako projektligjesh të normohet ndonjë fushëveprimtari e rëndësisë së veçantë, siç ndodh në parlamente tjera. Është krijuar përshtypja se projektligjet, jo rrallë, iniciohen vetëm sa për të bërë numër.

Edhe cilësia e ligjeve të miratuara lë shumë për të dëshiruar. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të qasjes bukur sipërfaqësore të të gjitha hallkave të shqyrtimit të ligjeve që nga Qeveria, Komisionet e Kuvendit ashtu edhe nga Seanca Plenare. Cilësia e punës së deputetëve ka qenë mjaft e ndikuar edhe nga kushtet bukur të papërshtatshme të punës, si dhe nga mosangazhimi i specialistëve të fushave të rëndësishme për procesin ligjvënës, në përkrahje të tyre.

Këto mangësi me zgjedhjen e Kryetarit të ri të Kuvendit z.K.Berisha janë trajtuar shumë më seriozisht dhe janë bërë përpjekje për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për t'i zbutur ato.

Përveç detyrës së bërjes së ligjeve, çdo parlament demokratik, detyrë mbi detyrat, ka kontrollin e pushtetit ekzekutiv.

Në këtë aspekt vërehen më së shumti shprehjet jo-demokratike të fituara më heret, aq sa mund të thuhet se deri më tani në Kosovë, nuk është parlamenti ai që e kontrollon qeverinë, por është e kundërta qeveria e dirigjon parlamentin.

Edhe në këtë drejtim ndërrimet në krye të kuvendit kanë dhënë sinjale pozitive. Sigurisht që me përmirësimin e praktikave ekzistuese parlamentare si dhe me aplikimin e praktikave të reja edhe kjo detyrë do të fillojë të përmbushet.

Pas ndryshimeve të fundit në Rregulloren të Punës së Kuvendit është instaluar praktika e pyetjeve parlamentare drejtuar qeveritarëve. Kjo praktikë ka qenë e paraparë edhe me rregulloren e parë të Kuvendit, por për shkak të mënyrës autoritare të udhëheqjes së tij, nuk ka mundur të zbatohet më heret.

Kjo praktikë pritet që, duke i vënë në siklet kryeministrin dhe ministrat e qeverisë, me anë të pyetjeve të ndryshme nga fushat e ushtrimit të pushtetit të tyre, ta rrisë tek ta domosdonë e përgatitjes më

të mirë gjatë ballafaqimeve në seanca parlamentare. Sa do të arrihet kjo mbetet të shihet, por qysh në fillimet e kësaj praktike bie në sy që shpeshherë ministrat po kanë nevojë për kohë shtesë përkundër faktit që pyetjet i marrin me kohë para seancave dhe kanë kohë të mjaftueshme për t'i menduar përgjigjet.

Edhe interpelancat si mënyrë e kontrollimit të ekzekutivit kanë filluar të praktikohen në kuvendin e Kosovës. Që të jenë më efektive duhet që të rritet serioziteti i të dyja palëve, si deputetëve që thërrasin në interpelancë ashtu edhe e ministrave që dalin para tyre.

Deri më tani kemi pasur disa interpelanca që nuk kanë pasur ndonjë efekt të theksuar qartësues, por kemi pasur edhe injorim të thirrjes në interpelancë nga ana e ministres për shërbime publike. Ky injorim nga ana e ministres Tërmkolli ia ka ulur dinjitetin Kuvendit tonë, por deri sa kjo të mos perceptohet kështu edhe nga deputetët që përbëjnë shumicën parlamentare, mund të ndodh fare lehtë që të kemi injorime dhe në raste të tjera në të ardhmen.

Sidoqoftë, përkundër të gjitha përparimeve gjatë punës së tij, Kuvendi i Kosovës ka shumë nevojë që t'i avansojë praktikën e tij parlamentare si dhe ta përmirësojë cilësinë e ligjeve që miraton, për të qenë në gjendje të ushtrojë përgjegjësitë e tij në atë mënyrë që t'u përgjigjet sfidave zhvillimore të Kosovës së pavarur.



Përgjegjësia e qeverisë ndaj kuvendit

Dejvid Pejn, Instituti Nacional Demokratik (NDI)



Që nga fillimi i qershorit 2006, kur deputetët e Kuvendit vendosën që në kuadër të veprimtarisë së tyre ta përfshijnë edhe seancat e obligueshme të pyetje-përgjigjeve, Kuvendi i Kosovës ka nisur punën me një imazh të ri, krejtësisht ndryshe nga i mëparshmi.

Zakonisht, përmes pyetjeve parlamentare kërkohet ndonjë informatë apo edhe ndër-marrja e ndonjë veprimi nga qeveria. Pyetjet i obligojnë ministrat që të japin sqarime dhe ta arsyetojnë punën e tyre, vendimet politike si dhe punën e ministrive të tyre. Të gjitha pyetjet regjistrohen në Buletinin Zyrtar të Kuvendit. Kështu është e përshkruar dhe parashikuar edhe me Rregulloren të Punës.

Deputetët u ankuan për arsye se lidhur me mbikëqyrjen e ekzekutivit kishte vetëm një numër të vogël "pyetjesh" nga një mori sosh që u parashtruan gjatë pesë viteve të shkuara. Për më tepër, gjatë gjithë kësaj kohe nuk ka pasur kohë të caktuar në agjendë për parashtrimin e pyetjeve. Kështu që kur u parashtruheshin pyetje

ministrave, ata rrallëherë përgjigjeshin. Përgjigjet nganjëherë jepeshin me shkrim dhe me nga disa muaj vonesë. Ministrat shpeshherë madje nuk ishin fare prezent gjatë debateve. Shumë prej tyre nuk e kanë pasur të qartë se janë të obliguar t'i përgjigjen Parlamentit. Veç kësaj, kryetari i Parlamentit në të shkuarën madje nganjëherë refuzonte t'ua përcillte pyetjet e deputetëve qeverisë.

Ndërkaq, sa i takon Interpelancës me ministrat e qeverisë asnjë debat nuk është mbajtur gjatë pesë viteve të shkuara, përkundër kërkesave të shumta, dhe dispozitave të qarta në Rregulloren e Punës.

Përpos këtyre, interesimi i publikut për punën e Kuvendit sa vinte e zbehej. Rrallëherë mund të shihej publik në galerinë e vizitorëve. Nuk kishte vend të caktuar për media. Nuk kishte madje as Agjendë standarde për seancat e Kuvendit. Kështu që, Agjenda ishte e paparashikueshme dhe në të kaluarën dukej se reflektonte më tepër tekat e kryetarit të Kuvendit se sa prioritetet e deputetëve. Komisionet shpeshherë shfaqnin pakënaqësinë e tyre ngase ishin të shtrënguara të miratonin legjisllacionin pa pasur sa duhet kujdes. Ndërsa, Komisioni për Buxhet dhe Financa u ankua se nuk kishte kohë të mjaftueshme për të shqyrtuar, amenduar dhe miratuar si duhet buxhetin e Kosovës.

Ishte e qartë se mungonte një ekuilibër. Qeveria priste nga Kuvendi t'i miratonte draft ligjet shpejtë. Por, deputetët

e Kuvendit ndiheshin të irrituar për arsye se roli i tyre si mbikëqyrës dhe vlerësues të politikave dhe veprimtarisë qeveritare vazhdimisht shpërfillej apo injorohej.

Me 10 mars 2006 Kolë Berisha u zgjodh Kryetar i Kuvendit.

Në fjalimin e tij me rastin e marrjes së detyrës ai shprehu gatishmërinë dhe vullnetin e tij për t'i adresuar shqetësimet e deputetëve. Së këndejmi, ai menjëherë filloi me një mori konsultimesh me shefat e grupeve parlamentare, kryetarët e komisioneve dhe anëtarët e Kryesisë. Kërkesat e tyre për ndryshime ishin të qarta. Ndërkohë ai – së toku me shumë vëzhgues të jashtëm- erdhi në përfundim se Rregullorja e Punës ishte mjaft e ngurtë dhe se pengonte një mbikëqyrje kredibile të qeverisë nga ana e Kuvendit.

Në kohën kur Grupi i Kontaktit dhe bota flisnin për standardet që Kosova duhet t'i plotësojë për ta njohur statusin e ardhshëm të Kosovës, Kuvendi i cytur nga propozimet dhe rekomandimet e Kryetarit Berisha për ndryshime, miratoi planin e vet për standarde.

Së këtejmi, reforma për mënyrën e mbajtjes së seancave dhe funksionimin e Kuvendit u miratua nga Kuvendi pothuajse njëzëri. Siç vuri në dukje vetë Kryetari me këtë rast, Rregullorja e punës duhet të jetë në shërbim të Kuvendit dhe jo anasjelltas.

Tani deputetët mund të kërkojnë përgjigje për çështje të rëndësishme aktuale nga qeveria aty për aty. 50 minuta të çdo dite të punës në Parlament

i kushtohen mbikëqyrjes dhe veprimtarisë së qeverisë, ndaj tani pjesa e seancës së pyetje-përgjigjeve është bërë pjesë e rëndomtë e Agjendës së Kuvendit, e cila mbahet në fillim të çdo seance.

Numri i madh i pyetjeve që janë parashtruar dëshmon më së miri se ka pasur vërtetë nevojë për ndryshime. Kështu, vetëm gjatë pesë seancave janë shkëmbyer 35 pyetje-përgjigje midis deputetëve dhe qeverisë. Pra, janë parashtruar tri herë më shumë pyetje se sa gjatë gjithë pesë viteve të shkuara, që kur ka nisur nga puna Kuvendi i ri! Sipas Rregullores së re, pyetjet e deputetëve dorëzohen drejtpërdrejt në Zyrën për Parashtrësia së paku dy ditë para fillimit të seancës. Zyra për Parashtrësia pastaj ia dërgon pyetjet Kabinetit të Kryeministrit. Ndërsa, nga ministri pritet që të marrë pjesë në seancë kur përmendet ministria e tij/ saj. Në seancë pyetja e shkruar përsëritet gojarisht. Rëndom parashtruesi i pyetjes ngrihet për t'iu drejtuar ministrit, dhe pret përgjigje. Ndërkaq, ministri më pas del në podium dhe ballafaqohet me kolegët e tij deputetë. Mirëpo, me këtë rast mund të bëhen pyetje shtesë aty për aty pa paralajmërim. Ky është model i llogaridhënies së qeverisë, dhe është mjaft i qartë. Sipas Rregullores deputetët kanë të drejtë t'i informojnë kolegët e tyre deputetë për pyetjen nëse ministri mungon gjatë dy seancave. Pyetjet nuk shqyrtohen dhe filtrohen më nga Kryesia. Procedura është mjaft e thjeshtë, ndërsa rezultatet faktojnë për efika-

sitetin e arritur në punë pas ndryshimeve të kohëve të fundit.

Kryeministri Çeku e ka bërë të qartë se ka ndërmend që të sigurojë prezencën e ministrave gjatë procedurave të mbikëqyrjes. Gjer më tani, pjesëmarrja e ministrave në seancat e pyetje-përgjigjeve ka ardhur gjithnjë në rritje.

RTK-ja është duke bërë transmetimin e drejtpërdrejt të seancave. Së këndejmi, ky është një moment i rrallë për shikuesit, ngase mund të ndjekin drejtpërdrejt seancat e pyetje-përgjigjeve dhe debatin parlamentar mbi çështje dhe probleme shumë të rëndësishme ditore.

Ja dhe ca shembuj nga seancat e pyetje-përgjigjeve: Grupi parlamentar "Për integritim" bëri një pyetje lidhur me pagat në shërbimin shëndetësor. Një deputet e pyeti Ministrin për kthim dhe komunitete rreth punësimit të minoriteteve në këtë ministri. Ai e morri përgjigjen në pyetjen e parashtruar, por deputeti bëri edhe një pyetje

shtesë. Deputetët e PDK-së parashtruan shumë pyetje, si fjala vjen ato për ambientin, që nxitën një debat mjaft të gjallë. Një tjetër pyetje kishte të bënte me ndërprerjet e papranueshme të energjisë elektrike. Ndërkaq, ORA e shfrytëzoi kohën e saj për t'i ngritur shqetësimet e saj lidhur me problemet në shëndetësi, si dhe ngriti çështjen e aktiviteteve ilegale të operatorëve të telefonisë mobile në Pejë.

Partitë në pushtet zakonisht nuk bëjnë pyetje për kolegët e tyre të partive që mbajnë poste ministrore për arsye të caktuara. Mirëpo, LDK-ja e ka shfrytëzuar rastin, kur opozita doli nga seanca në shenjë proteste, që t'i bëjë pesë pyetje gjatë kësaj seance, duke marrë ca përgjigje ironike nga ministrat e LDK-së.

Në një analizë të bërë kohëve të fundit nga NDI-ja me 85 deputetë të Kuvendit të Kosovës, 96% e tyre ishin dakord dhe madje fuqimisht besonin se seanca e pyetje-përgjigjeve është një mekanizëm i rëndësishëm për

procesin e mbikëqyrjes, ndërsa 100% të këtyre deputetëve pajtoheshin dhe madje ishin të kandisur se seanca e pyetje-përgjigjeve bën të mundur informimin e publikut lidhur me punën e Kuvendit. Njëherësh, sipas analizës, këta deputetë konsiderojnë se llogaridhënia e qeverisë ndaj qytetarëve është prioriteti më të lartë.

Për t'i bërë ndryshimet në Rregulloren e Punës më të mirëfillta dhe më efikase, është parashikuar që një grup parlamentar apo gjashtë (6) anëtarë të kenë të drejtë të kërkojë interpelancë qoftë me Kryeministrin apo edhe me ministra të qeverisë lidhur me çështje të caktuara me interes publik. Debati mund të zgjasë deri në dy orë. Ndërkaq, kërkesat për interpelancë nuk janë refuzuar asnjëherë gjer më tani. Madje ato tanimë janë bërë pjesë e agjendës së zakonshme. Ministrat që i drejtohet interpelanca duhet të japë sqarime dhe ta mbrojnë punën dhe veprimet e tij në Parlament. Debati i parë publik kishte të bënte pikërisht

me Kryeministrin Çeku, i cili i arsyetoi dhe i mbrojti veprimet e tij gjatë një debati në lidhje me Ligjin mbi statusin e familjeve të heronjve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-ës dhe të familjeve të viktimave civile të luftës. Ai me këtë rast dha sqarime dhe kërkoi falje përpara Kuvendit, gjë që u konsiderua si një sqarim i drejtë dhe i ndershëm. Është e udhës të vihet në dukje po ashtu se gjer më tani janë mbajtur tri interpelanca.

Ndërkohë, NDI-ja ka bërë edhe një analizë të punës së parlamenteve të tjera në Ballkan. S'do mend se për shkak të miratimit të ndryshimeve Kuvendi i Kosovës me këtë rast kishte demonstruar standarde të larta të transparencës dhe përgjegjësisë.

Së këndejmi, Kosova ka vërtetë arsye që të mburret me ndryshimet e kohëve të fundit në Parlamentin e saj.

Dejvid Pejñ është Drejtor për programe legjislativë në NDI. Ai po ashtu ka qenë edhe deputet në Kuebek të Kanadës për shumë vite, para se të emërohej Komisioner për tregti në Kinë.



Mbështetja e Kuvendit të Kosovës nga katër parlamentet kryesore të Evropës

Zhak Roxher-Maqart, Udhëheqës i ekipit të projektit dhe nënkryetar i mëparshëm i Asamblesë Kombëtare Frënge.



Me 23 maj 2006, kryetari i Kuvendit Kolë Berisha mbajti një konferencë për shtyp për të prezantuar projektin për "Përkrahjen e Kuvendit të Kosovës", që financohet nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER-i) dhe zbatohet nga konzorciumi i parlamenteve të katër vendeve: Francës, Gjermanisë, Belgjikës dhe Sllovenisë dhe Instituti Ndërkombëtar për Mbrojtje i Parisit (Institut International de Paris La Defense).

Kështu që, në prag të rezolutës së Këshillit të Sigurimit, përmes së cilës Kosova do të ketë fitojë status të ri, kjo përkrahje zyrtare nga katër parlamente të vendeve të Evropës është shenjë e njohjes ndërkombëtare të Kuvendit të Kosovës. Ndërkaq, porosia e anëtarëve të konzorciumit ishte se ata do të punojnë me Kuvendin e Kosovës si partnerë, duke shkëmbyer me këtë rast përvoja dhe praktika të mira si palë dhe partnerë të barabartë. Së këndejmi, nuk do të ketë kurrfarë kujdestarie, monitorimi apo eksportimi të ndonjë modeli, por vetëm propozime për Kuvendin e Kosovës, duke e lënë në përgjegjësi të Kryesisë, komisioneve dhe grupeve parlamentare dhe Sekretariatit për të vendosur për mënyrat dhe format e ndërtimit të Parlamentit të TYRE të mirëfilltë dhe bashkëkohor.

1. Kuvendi është institucioni kryesor demokratik në

Kosovë

Kur të krahasojmë Kornizën Kushtetuese me kushtetutat e vendeve të tjera perëndimore, do të shohim se në shumicën e shteteve të tjera, eksitojnë dy Dhoma që dalin nga zgjedhje të ndryshme, dhe madje edhe Presidenti në disa vende si ShBA dhe Franca zgjidhet në mënyrë të drejtpërsëdrejti nga qytetarët. Ndërkaq, në Kosovë ekziston vetëm një burim i legjitimitetit demokratik - Kuvendi që është zgjedhur drejtpërsëdrejti përmes votës së qytetarëve - i cili më pas zgjedh Presidentin e Kosovës, Qeverinë, voton ligje të ndryshme, e kontrollon ekzekutivin, etj.

Së këtëjmi, është shumë me rëndësi, për funksionimin e mirë të institucioneve, që Kuvendi të punojë në mënyrë demokratike dhe transparente, duke e zbatuar në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme Rregulloren e Punës, sipas një Agjende të përcaktuar qartë, si dhe nën udhëheqjen e Kryesisë të organizojë debate në mënyrë sa më konsensuale. Ndërsa, Sekretariati duhet të jetë nën kontrollin e Kryesisë, duhet të ketë staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar si dhe mjete të mjaftueshme për të mbështetur deputetët në kryerjen e detyrave të tyre.

Pikërisht për këtë arsye pjesa e parë e Projektit të AER-it ka të bëjë me mbështetjen e Kryesisë, komisioneve, grupeve parlamentare dhe Sekreta-



riatit. Me këtë rast, janë parashikuar vizita studimore në parlamentet e vendeve që janë pjesë e këtij konzorciumi me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave dhe vizitave të shkurta të ekspertëve në Kosovë për "trajtime gjatë punës", ndërkaq ekipi permanent i ekspertëve kryesorë, që është i vendosur në Kuvend, vazhdon të ofrojë ndihmë në bazë ditore.

2. Një Kosove moderne do t'i nevojiten ligje të qëndrueshme, që janë në pajtim me standardet Evropiane

Duke mbajtur parasysh se Kosova ka para vetes jo vetëm pavarësinë, por edhe procesin për integrim në BE, ajo duhet t'i ndërtojë themelet e një Shteti modern, duke miratuar ligje të përshtatshme dhe të qëndrueshme, që janë në pajtim me standardet Evropiane. Kjo nuk do të thotë se duhet të keni shumë ligje, por para së gjithash duhet të nxirrni ligje të mira.

Tani projekti i AER-it është

duke i mbështetur komisionet dhe stafin mjaft të përkushtuar të Sekretariatit në shqyrtimin, amendimin (sidomos në verifikimin e përputhshmërisë së ligjeve me standardet e BE-së dhe përafrimin e tyre me "acquis communautaires") dhe në votimin e draft ligjeve të propozuara nga Qeveria apo deputetët e Kuvendit. Ndërsa, së toku me partnerët e tjerë ndërkombëtarë, si NDI-ja, është duke e verifikuar pajtueshmërinë e draft ligjeve me legjislacionin ekzistues, mbikëqyrjen e implementimit të ligjeve, kontrollimin e ekzekutivit. Kjo është detyra kryesore e dy ekspertëve të përhershëm kryesor ligjorë: Alfons Lentzes dhe Virtyt Ibrahimagës.

3. Demokracia nuk ka të bëjë vetëm me votim të kohëpas-kohshëm në zgjedhje; por, është një proces i bashkë-veprimit të përditshëm me shoqërinë civile

Kriteret ndërkombëtare, sidomos kur ato vihen në jetë në një kontekst të kulturës post-

komuniste, mund të kënaqen me formalitetin e zgjedhjeve transparente, që mbahen një herë në disa vjet. Në ndërkohë, politikanët dhe shërbyesit civilë mund të punojnë "seriozisht", ndërsa Kuvendi vetëm t'i miratojnë formalisht vendimet.

Nuk është kjo filozofia e projektit dhe Konzorciumit: përkrimi i punës sonë thekson objektivën e ndërveprimit ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile. Një proces i këtillë kërkon shumë më tepër sa i përket demokracisë së mirëfilltë. Kjo nënkupton, që përmes dialogut të vetë deputetëve me pjesëtarët tjerë, debatet e grupeve të tyre parlamentare, punët e komisioneve (dëgjimet publike, ekspertizat në fushën e hetimeve, etj.), pyetjet drejtuar qeverisë dhe komisioneve hetuese, marrëdhëniet e Kuvendit me publikun dhe mediat, qasja e publikut në punët e Kuvendit etj. Aktualisht, është në vazhdim sipërnjendërveprim konstant dhe i përhershëm ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile.

Kjo është një objektivë specifike e komponentës së tretë të projektit. Por, kjo gjithashtu është një çështje tërthore përmes dy komponentëve tjerë, ku shumë aktivitete merren me shoqërinë civile. Kjo objektivë madhore do të bëhet më e qartë me zhvillimin e projektit gjatë 24 muajve të zbatimit të tij.

Këshilli drejtues, përgjegjës për miratimin e orientimeve dhe planeve të njëpasnjëshme tremujore të punës është themeluar më 22 maj. Pasi që, kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha ishte jashtë vendit, mbledhja e parë u kryesua nga z. Sabri Hamiti. Është shumë me rëndësi, që e tërë kryesia

dhe kryesuesit e Sekretariatit e përbëjnë bërthamën e këtij Këshilli. Kjo do të thotë, që i tërë institucioni përfaqësohet nga: shumica dhe opozita, deputetët dhe shërbyesit civil. Përveç AER-it, i cili është vendimmarrësi final i autoritet kontraktues, gjithashtu është me rëndësi pjesëmarrja e: Përfaqësuesit të Komisionit të BE-së, ASI-t ngase projekti funksionon në bashkëpunim të ngushtë me donatorët tjerë, veçanërisht me USAID-in dhe IKD-në; përfaqësuesit e konzorciumit: të katër Parlamentet, ku faktikisht janë prezentë së bashku me Institutin Ndërkombëtar i Mbrojtjes në Paris.

Në takimin e parë u miratua raporti fillestar, që përfshinte planin e përgjithshëm të aktiviteteve dhe planin e punës deri më 4 tetor 2006. Plani i punës në vijim do të propozohet për mbledhjen e ardhshme të Këshillit drejtues që është planifikuar të mbahet në fund të muajit shtator.

Veprimet e para janë në vazhdim, duke theksuar mbështetjen e procesit legjislativ nga dy ekspertë ligjor, por gjithashtu edhe me vizita studimi për njësitë e caktuara të Sekretariatit (Departamenti i Drejtësisë në Gjermani dhe Francë, dhe Departamenti për personel në Belgjikë) dhe misionet afatshkurta të ekspertëve (nga Sllovenia për përgatitjen e buxhetit të Kuvendit, nga Franca për punën e Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë, nga Belgjika për Shtypin dhe Publikimet).

Këto aktivitete do të zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e ASI-it, me qëllim që t'i përgjigjet në mënyrë të qëndrueshme nevojave të Kryesisë dhe Sekretariatit të Kuvendit.

Programi i vitit 2006 për mbështetje të negociatave

Në kuadër të programit të vitit 2006 për mbështetje të negociatave, me 12 korrik OSBE-ja organizoi një tryezë të rumbullakët për marrëdhëniet me mediat dhe publikun me Dr. Xhimi Shian, ish zëdhënës i NATO-s dhe tani Drejtor për Planifikim të Politikave në Zyrën Personale të Sekretarit të Përgjithshëm. Në epiqendër të vëmendjes së tryezës ishin politikanët e të gjitha partive politike përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e pakicave, aktivitetet e të cilëve mbulohen nga mediat. Ndërsa, qëllimi kryesor i tryezës ishte që t'u ofrojë atyre këshilla rreth angazhimit në media dhe zhvillimit të strategjisë së komunikimit në kontekstin e bisedimeve për status si dhe përgatitja për periudhën pas statusit. Veç kësaj, Dr. Shia pati edhe takime me Kryeministrin Çeku, Kryesin e detyrës së PSSP-së Stivën Shukun dhe liderin e ORA-s Veton Surroin.



Ndërkaq, në kuadër të Programit të vitit 2006 për mbështetje të negociatave, OSBE-ja me 9 qershor organizoi një seminar për zgjidhjen e problemeve dhe shkathësitë negociuese për komunitetet pakicë jo-serbe. Në këtë seminar ligjëruan z. Dejvid Still nga Shtetet e Bashkuara dhe z. Vjekoslav Saje nga Bosnja dhe Hercegovina. Në seminar u shqyrtuan aspekte të rëndësishme konceptuale të zgjidhjes së problemeve, shkathtësive udhëheqëse dhe planifikimit të marrëdhënieve.



“Parlamentarët gjithnjë udhëtojnë jashtë vendit” – diku në mes të urtësisë tradicionale, paragjykimit, dhe ankesës, është ky një besim i cili ekziston pothuajse në mbarë botën. Po a thua vallë cila është arsyeja e ekzistimi të kësaj klisheje? Ç’është e vërteta, ekzistojnë shumë arsye të mirëfillta për këtë. Kështu, profesionistët e fushave të ndryshme konsiderojnë se këmbimi i përvojave dhe mundësia për të mësuar nga njëri është një gjë tejet e rëndësishme, dhe kjo vlen veçanërisht për parlamentarët, pikërisht për shkak të specifikave të punës së tyre. Në fund të fundit, ata, sipas definicionit janë të vetmit profesionistët të asaj fushe në vendet e tyre.

S’ka pikë dyshimi se me rastin e takimeve të parlamentarëve nga vendet e ndryshme ata kanë shumë pyetje që do të dëshironin t’i bënin njëri-tjetrit, fjala vjen:

“Si funksionon mbajtja e dëgjimeve publike në parlamentin tuaj?”

“Si e ushtron parlamenti mbikëqyrjen e veprimtarisë së sektorit të sigurisë?”

“Çfarë statusi ka Komisioni për Integritet Evropian në vendin tuaj në krahasim me atë të vendeve të tjera?”

Vlen të vihet në dukje se për parlamentet e Evropës Juglindore sa më tepër që të thellohen proceset e demokratizimit dhe të integriteteve euroatlantike, aq më i rëndësishëm bëhet dimensionin ra-

jonal i bashkëpunimit parlamentar. Ndaj, është e qartë se bashkëpunimi ndërkombëtar është njëri ndër kushtet kryesore për integrim në BE. Ndërsa, perspektiva e përbashkët e anëtarësimit në BE është një nga motivet dhe cytjet kryesore për ndërtimin e një bashkëpunimi më të fuqishëm rajonal.

Që nga viti 2005, kur u bë e qartë edhe zyrtarisht se bashkëpunimi parlamentar është qëllimi kryesor i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, aktivitetet në këtë fushë janë shtuar dukshëm. Po kështu, në 2005-ën shtetet që marrin pjesë në Procesin e Stabilizim Asocimit themeluan Konferencën e përhershme të komisioneve parlamentare për integritet evropian Ndërkaq, që nga viti 2004, Parlamenti i Malit të Zi është duke organizuar Forumin Parlamentar të Cetinës, ku takohen kryetarët e parlamenteve apo anëtarët e komisioneve të ngjashme. Pos kësaj, në kuadër të Procesit të bashkëpunimit të vendeve të Evropës Juglindore, kryetarët e Parlaamenteve takohen një herë në vit.

Rritja e numrit dhe e cilësive së aktiviteteve rreth bashkëpunimit bilateral dhe rajonal është një sinjal i mirë dhe i rëndësishëm për thellimin e mëtejme të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve midis parla-menteve në Evropën Juglindore. Marrëveshjet për tregti të lirë, regjimet më liberale të vizave, bashkëpunimi rreth luftës kriminale të organizuar, zhvillimi i infrastrukturës së përbashkët dhe politikat për investime përbëjnë mundësi tejet të mëdha ku mund të shtrihet dhe

të zgjerohet bashkëpunimi parlamentar.

Për shkak të statusit të pagzjidhur të Kosovës, deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk kanë marrë pjesë rregullisht në takimet ndër-parlamentare, mirëpo megjithatë ata gjithnjë e më tepër janë duke marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, programe të trajnimit apo takime parlamentare rajonale. Deputetët e Kuvendit të Kosovës gjatë disa viteve të shkuara kanë marrë pjesë aktivisht në Programin “Legjislatura dhe Qytetarët” të Projektit për Praktikën Parlamentare Lindje-Perëndim që financohet nga Holanda. Ndërsa, gratë parlamentare nga Kosova janë përfshirë në Projektin e financuar nga Gjermania për shkëmbime parlamentare të grave të vendeve të Evropës Juglindore, që fokusohet në çështjet si puna-jeta- balanci dhe mësimi gjatë gjithë jetës. Veç këtyre, edhe në takimet e Asamblesë Parlamentare të NATO-s kanë marrë pjesë delegacione të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. E gjithë kjo është shenjë e normalizimit, përmirësimit dhe thellimit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe rajonale.

S’do mend se deputetët e Kuvendit të Kosovës do të dëshironin që të vazhdonin thellimin e mëtejme të marrëdhënieve jo vetëm duke marrë pjesë në takimet parlamentare rajonale, por edhe duke qenë vetë nikoqir të këtyre takimeve në Kosovë. Një shembull i mirë i bashkëpunimit të frytshëm midis parlamentarëve nga Evropa Juglindore ka qenë edhe Tryeza e Rrumbullakët mbi Mbikëqyrjen Parlamentare e organizuar nga OSBE-ja e

mbajtur në qershor të vitit 2005 në Prishtinë. Në këtë Tryezë parlamentarët nga Rumunia, Kroacia, Serbia dhe Maqedonia patën rastin që përmes shembujve praktik t’i sqarojnë; dhe shkëmbejnë përvojat e tyre mbi instrumentet e suksesshme të kontrollit parlamentar të qeverisë. Me këtë rast, ishte mjaft me interes mënyra se si parlamentarët nga vendet e ndryshme aktruan dhe simuluan së bashku si përfaqësues të qeverisë apo të deputetëve të grupeve parlamentare nga pozita dhe opozita. Pa dyshim se të gjithë parlamentarët u kthyen në vendet e tyre me ide të reja dhe me një inspirim më të madh për rritjen e efikasitetit të punës në parlamentet e tyre. Përpos kësaj, Kuvendi i Kosovës ishte nikoqir i Konferencës së Parlaamenteve të Rajonit, të organizuar për herë të dytë nga OSBE-ja (ku u diskutua rreth mbikëqyrjes së sigurisë), që u mbajt në Mitrovicë prej 25 deri me 27 qershor. Kjo konferencë do të bëjë të mundur jo vetëm shkëmbimin e frytshëm të ideve dhe përvojave, por edhe normalizimin dhe thellimin e mëtejme të marrëdhënieve fqinjësore. Ndërsa, për të marrë pjesë në këtë ngjarje, kolegët nga parlamentet e vendeve fqinje edhe kësaj radhe patjetër është dashur të udhëtojnë - mirëpo, s’ka pikë dyshimi se ata kanë pasur arsye të mirëfillta për të bërë këtë.

Petra Blas ka qenë Këshilltare e lartë e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës nga Misioni i OSBE-së në Kosovës, ndërsa gjatë periudhës 1998-2002 ka qenë deputete e Bundestagut Gjerman dhe nënkryetare e Bundestagut Gjerman.

Integrimi evropian ecën me hapa të shpejtë

Alfons B. Lentze, këshilltar i projektit 'Mbështetja e mëtutjeshme për Kuvendin e Kosovës'. Projekt i financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga AER-i dhe zbatuar nga Konzorciumi i Kuvendeve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës dhe Sllovenisë si dhe Institutit ndërkombëtar për mbrojtje i Parisit.



Siç është përmendur edhe në ueb faqen e Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim në BE i Kuvendit të Kosovës është përgjegjës për diskutimin e të gjitha çështjeve, që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe IPVQ-të, bazuar në dispozitat e Kornizës Kushtetuese; zhvillimi i strategjisë së përgjithshme për bashkëpunim ndërkombëtar për Kuvendin dhe institucionet tjera të Kosovës, veçanërisht bashkëpunimi i këtyre organeve me parlamentet e vendeve tjera, si dhe me institucionet ndërparlamentare në nivele të ndryshme; si dhe mbikëqyrja e zhvillimit të suksesshëm të punës së institucioneve në bashkëpunimin ndërkombëtar, veçanërisht përsheptimit të procesit të zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës, në pajtim me vullnetin e popullit dhe të drejtën për vetëvendosje.

Ndonëse, komisioni në emrin e tij mbartë aspektin e

integritimit në BE në pikat kryesore të paraqitura në faqen e Internetit të Kuvendit, një gjë e tillë nuk reflektohet në takimet e komisionit. Siç duket Komisioni më shumë do të përqendrohet në bashkëpunimin ndërkombëtar në përgjithësi dhe në statusin përfundimtar të Kosovës se në strategjitë specifike dhe politikat e BE-së për integrim. Konfuzioni mund të jetë rezultat i emrit të komisionit të përmendur në Rregulloren e Punës të Kuvendit të Kosovës nën rregullën 48, ku emri i Komisionit është si vijon: Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritime Euro-Atlantike. Por në veprën e Shekspirit "Romeo dhe Zhulieta" thuhet "Oh ki një emër tjetër! Po ç'ka një emër? Çdo emër s'i humb erën e trëndafilin" (shënim i përkthyesit, marrë nga Alqi Kristo). Këtu Zhulieta ia bën me dije Romeos, që emri është një traditë artificiale dhe e pakuptimtë.

Pra, për të kaluar në realitet, komisioni megjithatë nuk

duhet ta nënçmoj rëndësinë e zhvillimit dhe diskutimit të politikave të Kuvendit, si dhe strategjitë lidhur me integrimin në BE, duke e pasur parasysh bashkëpunimin ndërkombëtar dhe statusin përfundimtar. Së bashku me Agjencinë e re për Integrim Evropian të Kryeministrit, Komisioni mund të punoj në strategjitë dhe politikat, duke e ditur që Kosova merr pjesë pjesërisht në politikat e BE-së për Ballkanin Perëndimor përmes mekanizmave mbështetës të procesit të stabilizim-asocimit. Ky mekanizëm, i krijuar në nëntor të vitit 2002, ua mundëson institucioneve për të përfutur plotësisht nga elementet kyçe të procesit së stabilizim-asocimit, siç është mbështetja financiare, konsultimet mbi politikat, koncesionet për treg dhe monitorimi i standardeve të BE-së. Përmes këtij mekanizmi, Kosova ndihmohet në arritjen e reformave strukturale të nevojshme për përafrim në BE dhe themelimin e institucioneve, si dhe vetëdijesimi i administratës për synimet dhe parimet mbi të cilat ndërtohen politikat dhe praktikate evropiane. Së bashku me Agjencinë, Komisioni mund ta udhëheqë, koordinoj, monitoroj dhe siguroj procesin e integritimit evropian në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe në popullatë. Më tej, me ndihmën e tyre Komisioni mund të udhëheq në përmbushjen e rekomandimeve të dalura nga procesi i stabilizim-asocimit, si dhe monitorimi teknik dhe koordinimi në ministri në zbatimin e standardeve për

Kosovën, veçanërisht në situatë ku këto korrespondojnë me rekomandimet e mekanizmit përcjellës.

Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim në BE (Integritime Euro-Atlantike) të Kuvendit të Kosovës mund t'i rishikoj funksionet dhe përgjegjësitë e veta, në mënyrë që ta organizoj punën me Agjencinë për integrim në BE.

Komisioni mund të diskutoj me Agjencinë për koordinimin e aktiviteteve të qeverisë në radhitjen e praktikave dhe aktiviteteve legislative me normat dhe standardet relevante të BE-së në kontekst të procesit të stabilizim-asocimit të BE-së (PSA), me synim të lehtësimit të reformave ekonomike, sociale si dhe reformat tjera për mbështetjen e përfshirjes së Kosovës në proceset e integritimit evropian. Komisioni mund të vazhdoj të merret së bashku me Agjencinë rreth koordinimit të aktiviteteve qeveritare lidhur me përafrimin në BE dhe pjesëmarrjen në PSA me UNMIK-un. Komisioni mund të diskutoj dhe formuloj së bashku me Agjencinë propozimet për avancimet e aktiviteteve të qeverisë për përafrim me normat dhe standardet e BE-së, si dhe mbështetjen për ti kuptuar më mirë politikat dhe vendimet e BE-së, si dhe efektet praktike nga kjo. Mund të merret rreth koordinimit të Agjencisë në përgatitjen e saj dhe shërbimet në kohë të inputeve të qeverisë lidhur me mekanizmin përcjellës të PSA për Kosovën. Me Agjencinë do të mund ta koordinonte zhvillimin

dhe zbatimin e programit të përgjithshëm qeveritar për përafrim me normat dhe standardet relevante të BE-së. Do të mund të koordinonte së bashku me Agjencinë mbikëqyrjen e procesit të zbatimit të standardeve dhe kërkesave sipas partneritetit evropian dhe procesit të stabilizim- asociimit. Po ashtu së bashku me Agjencinë mund të merren rreth rekomandimeve në kuadër të standardeve për Kosovën dhe proceset e mekanizmit përcjellës, përmes koordinimit me ministrinë përkatëse, dhe nëse e nevojshme edhe me UNMIK-un. Do të mund të monitoronte zhvillimin e legjislacionit të BE-së dhe politikat e rëndësishme për pjesëmarrjen në PSA dhe zbatimin e standardeve për Kosovën. Me Agjencinë do të mund t'i diskutonte propozimet e tij për zhvillimin e kapaciteteve të qeverisë për përafrimin legjislativ dhe verifikimin e kompatibilitetit me *acquis communautaire*, duke përfshirë propozimet mbi hapësirat prioritarë për harmonizimin legjislativ. Së bashku me Agjencinë mund ta mbikëqyrin përgatitjen e legjislacionit të IPVQ-ve, me synim për të siguruar përafrimin e legjislacionit të fillëme *acquis communautaire*. Mund të bëjë hulumtim në fushën e politikave dhe të zhvillimeve të BE-së dhe të mbajë kontakte me institucionet e interesuara dhe ekspertët lidhur me studimet e mirëfillta dhe analizat. Do të mund të bëjë mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve relevante të BE-së, organizimin e fushatave informative mbi çështjet lidhur BE-në. Mund të kërkojë nga Agjencia për të përgatitur pakot me udhëzime mbi PSA dhe zhvillimet e BE-

së. Do të mund të kërkonte nga qeveria për të organizuar dhe koordinuar përkthimin e dokumenteve dhe legjislacionin e BE-së, si dhe koordinimin e shqyrtimit të përkthimit të legjislacionit të IPVQ-ve dhe dokumentet për përafrim me terminologjinë e standardeve evropiane të BE-së dhe leksikon e *acquis communautaire*. Mund të diskutojë me Agjencinë, koordinimin në bashkëpunim me ministrinë për ekonomi dhe financa, si dhe me organet tjera relevante të qeverisë, donatorët për mbështetje financiare, praktike dhe mbështetje të ekspertëve për zhvillimin dhe zbatimin e programeve ndihmëse relevante për çështjet e përafrimit të BE-së; dhe të diskutojë me Agjencinë për themelimin dhe mirëmbajtjen në koordinim me ministrinë për ekonomi dhe financa dhe organet tjera relevante qeveritare, të programeve ndihmëse relevante për çështjet e përafrimit të BE-së.

Do të doja ta ftoj Komisionin që së bashku me Agjencinë t'i fillojë diskutimet në baza të rregullta për integrimin në BE dhe zhvillimin e strategjive dhe politikave. BE-ja – me shtetet anëtare të saj njihet si njëra ndër aktorët kryesor me influencë në avancimin e pajtueshmërisë etnike, fuqizimin e modelit të demokracisë duke u bazuar në standardet e Evropës perëndimore, dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik në Kosovë. BE-ja është e interesuar veçmas në shtetet e Ballkanit, dhe me atë rast strategjitë e zhvilluara t'i mbështesin këto vende, duke përfshirë edhe Kosovën, për të ecur drejt Evropës. Për të ecur përpara me hapa më

të shpejtë, disa do të donin ta avanconin perspektivën e anëtarësimit në BE. Megjithatë, do të thosha se për Kosovën më e rëndësishme pikësepër është që t'i ofroj qytetarëve të vetë një marrëveshje të mirëfilltë,, që për Kosovën do të thotë integrim në BE. Por, çfarë do të thotë integrimi evropian për Kosovën? Kjo do të thotë stimulim i vërtetë dhe i qëndrueshëm, që ngrihet mbi supozimin se përkushtimi i mirëfilltë ndaj integritit evropian në strukturat evropiane është një element përbërës i suksesit, që do t'i shërbejë reformimit të Kosovës dhe integritit të saj në rajon. Këshilli i Evropës ka konfirmuar se objektiva e tij është të ketë integrim të plotë evropian të vendeve të Ballkanit si dhe t'i integroj këto vende në rrjedhën e përgjithshme politike dhe ekonomike të Evropës.

Sido që të jetë, disa politikanë duket se e harrojnë këtë anëtarësimi në BE mund të ndodh vetëm pas marrëveshjes së duhur dhe ratifikimit të marrëveshjes për anëtarësim nga të gjitha shtetet anëtare. Shtete anëtare janë të interesuara vetëm në anëtarët e rinj, nëse këto shtete anëtare të reja bashkëpunojnë me BE-në për zhvillimin e tregtisë, zhvillimin ekonomik, barazinë e të gjithë individëve, arsimin dhe hulumtimin, bashkëpunimin rajonal dhe dialogun me shoqërinë civile. Këto janë gurë themeltar të BE-së për ta integruar Kosovën në rrjedhën e përgjithshme evropiane.

Po, nuk duhet të harrojmë se negociatat në vazhdim për statusin e ardhshëm të Kosovës janë të rëndësishme për tërë procesin e integritit evropian të Kosovës.

Sigurisht që anëtarësimi në BE mund të shihet si karota e përdorur nga disa politikanë për të realizuar integrimin evropian në Kosovë. Ndonëse, duhet të jemi të kujdesshëm dhe të mos vrapojmë verbërisht pas karotës, por të theksohet se çfarëdo anëtarësimi në BE mund të realizohet vetëm pas përmbushjes së kushteve të parashtruara, të cilat duhet t'i përcjellin strategjitë për ruajtjen e paqes, tolerancën etnike, reformën ekonomike po ashtu zvogëlimin e nacionalizmit, oportunitizmin e elitave të caktuara politike në kushtet e shtet formimit, pasigurisë ekonomike dhe separatizmit politik të grupeve etnike dhe pakicave.

Shikuar me sy optimist, Be-ja është këtu për ta mbështetur Kosovën në procesin e integritit. Do ti krijoj politikat e veta për Kosovën. Me partneritetin evropian të miratuar në janar të vitit 2006, BE-ja i ka dërguar mesazh të qartë autoriteteve të Kosovës, që përmbushja e standardeve të KB-ve nuk nevojitet vetëm për ta trasuar rrugën për zgjidhjen e statusit, por edhe për përmbushjen e kriterëve politike të Kopenhagës në afat të gjatë kohor. Këto kriterë janë rregullat, që definojnë nëse një komb është i denjë për t'iu bashkangjitur BE-së. Kjo kërkon që shteti ti ketë institucionet për ruajtjen e qeverisjes demokratike dhe të drejtat e njeriut, funksionim të ekonomisë së tregut, dhe që ajo t'i pranojë obligimet dhe synimin e BE-së.

Siç kemi parë tanimë në politikën e përditshme, BE-ja pretendon të bëhet forcë lëvizëse në kuadër të prezencës ndërkombëtare

Tryeza e rrumbullakët për hartimin e kushtetutës së re ndihmon në promovimin e vlerave demokratike në Kosovë

Dillan Kejs, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Pavarësisht nga rezultati i bisedimeve rreth statusit përfundimtar të Kosovës, kushtetutës së përkohshme të Kosovës - Kornizës Kushtetuese të KB-ve për Vetëqeverisje të Përkohshme- do t'i mbarojë afati.

Së këndejmi, kur të vijë koha liderët e Kosovës duhet të jenë të gatshëm që të japin kontributin e tyre për hartimin e kushtetutës së re, e cila do të bëjë të mundur si funksionimin e mirëfilltë të institucioneve, ashtu edhe mbrojtjen e të drejtat njerëzore.

Me qëllim që t'u vijë në ndihmë për t'i përballuar sfidat që ndodhen para tyre, Misioni i OSBE-së në Kosovë organizoi një Tryezë të Rrumbullakët të Parlamentarëve dhe Ekspertëve për Çështje Kushtetuese, e cila u mbajt në Shkup në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, prej 20 deri me 22 korrik të këtij viti.

Me këtë rast në Shkup u takuan përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve të Kosovës, qeverisë së përkohshme, Kuvendit të Kosovës dhe ekspertë të ndryshëm nga rajoni dhe bota, për t'i shkëmbyer idetë e tyre lidhur me çështjet kushtetuese.

Duke iu adresuar të pranishmëve me rastin e hapjes së takimit, Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë Ambasadori Verner Vnent, tha se: "OSBE-ja e ka organizuar këtë ngjarje në kuadër të ndihmës dhe mbështetjes së vazhdueshme për institucionet e Kosovës. Qëllimi i saj është



që t'u ndihmojë rreth thellimit njohurive, shkathtësive dhe profesionalizmit tuaj.

"Në sajë të praktikave të mira të vendeve të ndryshme të botës dhe të kontributeve të ekspertëve të shquar, ju do të fitoni njohuri të mirëfillta për procesin kushtetues."

Përgatitja për të ardhmen

Me këtë rast, Ambasadori Venent njëherësh vuri në dukje se konferenca nuk ka për qëllim që në asnjë mënyrë të ndikojë në rezultatin e bisedimeve për statusin, por që t'i përgatisë komunitetet e Kosovës për periudhën pas zgjidhjes së statusit.



Pjesëmarrësit diskutuan rreth çështjeve më të rëndësishme kushtetuese si fjala vjen mbrojtja e të drejtave njerëzore, sistemi i ndarjes së pushteteve, jetësimi i kushtetutës, transferi i kompetencave dhe institucionet.

"Muamëinteresojnë në mënyrë të veçantë institucionet, ngase qëllimi im dhe i kolegëve të mi është që në radhë të parë të kemi institucione të mirëfillta dhe funksionale si dhe qeveri efikase," theksoi Gjylnaze Sylja, deputete e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK-së).

"Procesi i hartimit të kushtetutës është po aq i rëndësishëm sa edhe vetë përmbajtja e saj. Ndërsa, kjo tryezë do të bëjë të mundur hapjen e derës për procesin e hartimit të kushtetutës."



Shkëmbimi i ideve në mënyrë të hapët

Pjesëmarrësit e konferencës po ashtu lavdëruan mënyrën e organizimit të tryezës meqë jo vetëm që ka ofruar praktika të shkëlqyeshme rreth procesit të hartimit, por ka bërë të mundur edhe një shkëmbim të hapur të koncepteve dhe qasjeve të ndryshme.

“Trajnimi nganjëherë mund të jetë proces i njëanshëm, por kjo mënyrë e organizimit kërkon pikëpamjet dhe kontributin e të gjithë pjesëmarrësve në mënyrë që në tryezë të shtrohen për diskutim të gjitha çështjet e vështira,” pohoi Frederik Lorenc ekspert kushtetues në Grupin për të Drejtën Publike Ndërkombëtare dhe Politika (PILPG).

Doracak për kushtetutën

Ekspertët nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara kanë punuar së toku me OSBE-në për të bërë të mundur diskutimin dhe hartimin e doracakut të konferencës mbi kushtetutat e vendeve pas konfliktit.

Ky doracak ka 116 faqe dhe në të janë përfshirë analizat krahasuese të mbi 150 vendeve, të ndara në nëntë kapituj tematikë, duke filluar nga dispozitat e preambulës deri te mbrojtja e të drejtave njerëzore. Në kaptina të ndryshme të këtij doracaku pos sqarimeve dhe vlerësimeve rreth avantazheve

dhe disavantazheve të procedurave të ndryshme të amendimit, strukturave të ndryshme të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, jepen madje edhe modele të gjuhës që mund të përdoren për hartimin e një drafti sa më të saktë, më të plotë dhe më të qëndrueshëm.

Doracaku në të tri gjuhët

shqip, serbisht dhe anglisht iu shpërnda 65 pjesëmarrësve të kësaj tryeze.

Zbatimi i teorisë në praktikë

Megjithatë, ende askush nuk ka iluzione se madje edhe kushtetuta më e përsosur do t’i zgjedhë problemet e Kosovës. Ngase historia na mëson se shpeshherë zbatimi i teorisë në praktikë është një punë mjaft e vështirë.

“Dokumentin nuk duhet shikuar në mënyrë të izoluar,” tërhoqi vërejtjen Lorenci nga PILPG-ja. “Ngaqë për jetësimin e tij lipset mbështetja si e publikut, ashtu edhe e zyrtarëve dhe e qeverisë.”

Mirëpo, përmes shkëmbimit të ideve dhe sigurimit të shkathtësive, njohurive dhe mundësive nga OSBE-ja dhe organizata të tjera, Kosovës po i bëhet e mundur që t’i sigurojë mjetet për krijimin dhe ruajtjen e një shoqërie demokratike.



Zhvillimet e kohëve të fundit në Kuvend

Franklin De Vrieze, OSCE Mission in Kosovo

Kuvendi miraton reformat

Me qëllim të përmirësimit të funksionimit të Kuvendit dhe të forcimit të mbikëqyrjes së qeverisë, Kuvendi në seancën plenare të datës 1-2 qershor votoi pothuajse në mënyrë unanime për pakon gjithëpërfshirëse të reformave, Planin për Standardet e Kuvendit, të përgatitur dhe iniciuar nga Kryetari i ri i Kuvendit. Me këtë rast, në mënyrë të veçantë u mirëpritën dispozitat lidhur me seancat e rregullta të pyetje-përgjigjeve. Gjatë seancave plenare në muajin qershor, korrik dhe gusht qeverisë iu parashtruan një mori pyetjesh. Gjer më tani, shumica syresh, megjithëse ende jo të gjitha pyetjet, kanë marrë përgjigje. Ndërkaq, me 23 qershor partnerët e ASI-it mbajtën një takim të përbashkët për të mbështetur pakon e reformave. Me këtë rast, projekti i financiar nga Instituti Nacional Demokratik (NDI), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe AER-i për përkrahjen e Kuvendit ofroi praktikat më të mira dhe këshilla konkrete si për deputetët e Kuvendit ashtu edhe për përfaqësuesit e mediave lidhur me seancat e pyetje-përgjigjeve dhe interpelancat në Kuvend.

PDK-ja kundër Kryeministrit Çeku për "Ligjin e veteranëve të luftës"

Në seancën plenare të 15 qershorit është mbajtur një debat pas interpelancës lidhur me miratimin e Ligjit për të drejtat e veteranëve të luftës së UÇK-së, familjeve të martirëve dhe viktimave civile të luftës. Me këtë rast, në emër të grupit parlamentar të PDK-së, z. Jakup Krasniqi hapi debatin, duke pohuar se ndryshimet e bëra në ligj pas miratimit të tij paraqesin një abuzim të pushtetit nga ana e PSSP-së dhe Kryeministrit, i cili "ka kompetenca për ta zbatuar ligjin, por jo edhe për ta nënshkruar atë." Ndërkaq, Kryeministri Çeku bëri të qartë se ai e nënshkroi ligjin, vetëm si një gjest simbolik, për shkak të rëndësisë që ka ligji. Njëherësh, ai bëri të ditur se për ndryshimet në ligj ishte informuar vetëm pasi e kishte nënshkruar atë dhe se për këtë arsye menjëherë kishte kërkuar sqarime nga PSSP-ja. Në vazhdim ai tha se kjo çështje tani është duke u shqyrtuar në Zyrën Ligjore të KB-ve në Nju Jork dhe se ai e pranon ligjin vetëm në formën që është miratuar nga Kuvendi. Ndërsa, lidhur me këtë rast kanë bërë deklaratatë edhe disa deputetë të grupeve të ndryshme parlamentare.

Delegacioni i Parlamentit Evropian viziton Kosovën

Me 21 qershor një delegacion i Parlamentit Evropian (PE), i kryesuar zonja Doris Pak në përbërjen e të cilit ishin edhe anëtarët e Komisionit për marrëdhënie me vendet e EJL, të Komisionit për marrëdhënie me jashtë dhe Nën-komisionit për siguri dhe mbrojtje vizitoi Kosovën. Me këtë rast, delegacioni u takua me Kryesinë e Kuvendit ku morën pjesë edhe përfaqësuesit e Komisionit të BE-së dhe UNMIK-ut. Në epiqendër të vëmendjes së këtij takimi ishte situata politike në Kosovë me theks të veçantë në bisedat aktuale për përcaktimin e statusit,

decentralizimin, prezencën e bashkësisë ndërkombëtare dhe progresin e arritur në zbatimin e standardeve. Pos kësaj, në këtë takim u diskutua edhe për mospjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në institucione. Ndërkaq, në fund të takimit të dy delegacionet miratuan një deklaratë të përbashkët, ku konfirmohet interesimi për intensifikimin dhe thellimin e mëtejme të marrëdhënieve.

PSSP Soren Jesen-Petersen mban fjalimin lamtumirës në Kuvend

Me 29 qershor PSSP Soren Jesen-Petersen mbajti fjalimin e tij lamtumirës në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës. Duke shfaqur bindjen e tij të thellë se statusi do të zgjidhet sivjet, Peterseni përkujtoi se çfarë ka mbetur të bëhet deri sa të vijë koha për marrjen e vendimit për status: vazhdimi i zbatimit të standardeve, konsolidimi dhe vazhdimi i mëtejme i transferit të kompetencave, forcimi i ekonomisë, ndërtimi i shoqërisë shumë-etnike, sundimi i ligjit dhe qartësimi i statusit. Lidhur me statusin, PSSP-ja në largim theksoi se Kosova nuk do të ndahet, se statusi duhet të jetë i pranueshëm për shumicën dhe se duhet pasur mirëkuptim edhe për nevojat e pakicave: "Unë besoj se gjatë realizimit të ëndrrës suaj, kjo ëndërr juaja do të shndërrohet edhe në ëndërr të të gjitha komuniteteve të tjera, në mënyrë që realizimi i saj të mos shndërrohet në ankth për të tjerët."

Grupi parlamentar për Integrim përfshihet në komisionet e Kuvendit

Aty nga fundi i vitit 2005, gjashtë parti politike që kanë përfaqësues në Kuvendin e Kosovës vendosën të themelojnë grupin e tyre parlamentar, Grupin për Integrim. Mirëpo, kërkesa për përfshirjen e grupit të ri në komisione nxiti debate intensive për disa muaj si në Kryesinë e Kuvendit ashtu edhe në mesin e shfave të grupeve parlamentare. Së këndejmi, nevoja për përfshirjen e grupit të ri në komisione pa "e prishur balancin politik" nëpër komisione, bëri që Kryesia të pajtohet me propozimin e ORA-s për shtimin e numrit të anëtarëve në secilin komision funksional nga 12 në 14, apo më konkretisht duke shtuar nga një anëtarë të opozitës dhe një nga radhët e partive të koalicionit qeverisës në secilin nga tetë komisionet funksionale. Kështu që, në seancën plenare të 29 qershorit iu dha mbështetje të gjithë anëtarëve të ri të komisioneve përfshirë këtu edhe ata nga Grupi për Integrim.

Kuvendi diskuton raportin mbi 100 ditë të punës së qeverisë

Në seancën e 12 korrikut, Kryeministri Agim Çeku bëri prezantimin e raportit mbi 100 ditët e para të punës së qeverisë. Me këtë rast, ai i bëri të ditura prioritetet kryesore të qeverisë së tij rreth bisedimeve për status, zbatimin të standardeve dhe ndërtimit të besimit si dhe mirëpriti 13 pikat nga plani i prioritetëve të Grupit të Kontaktit, i cili, sipas tij, do të zbatohet krahas bisedimeve për status. Më pas u mbajt një debat në seancë plenare, i cili zgjati gjashtë orë. Me këtë rast, nga njëra anë, deputetët nga radhët e koalicionit qeverisës e mbështetën

qeverinë në punën e saj dhe kërkuan një impenjim më të madh për realizimin e programit të saj. Ndërkaq, deputetët e opozitës, nga ana tjetër, kritikuan qeverinë për ngecjen në plotësimin e standardeve, shkeljen e ligjeve, nepotizëm, korrupsion dhe për dështim në shpërbërjen e strukturave paralele.

Kuvendi miraton propozimin për vazhdimin e ndërtimit të Qendrës Administrativo- Protokollare në Gërmi

Në seancën plenare të 17 korrikut u diskutua raporti dhe rekomandimet e Kryesisë së Kuvendit për Qendrën Administrativo- Protokollare në Gërmi Me 52 vota për dhe 18 vota kundër Kuvendi miratoi vazhdimin e punëve ndërtimore. Ndonëse deputetët e Kuvendit nga radhët e koalicionit qeverisës LDK- AAK votuan për vazhdimin e ndërtimit të kësaj qendre, ata megjithatë pranuan se ka pasur shkelje të procedurave dhe konflikt të interesave me rastin e përzgjedhjes së kontraktuesit. Ndërkaq, opozita reagoi ashpër duke e quajtur “legjitimim të veprimeve të paligjshme.” Pos kësaj, Jakup Krasniqi, deputet nga radhët e PDK-së kërkoi që të gjitha punimet të ndalen deri sa të marrë vendim gjykata. Ndërsa, Gazmend Muhaxheri deputet i ORA-s tërhoqi vërejtjen se përkundër të drejtës parimore që koalicioni ka për të mbivotuar opozitën në disa raste, koalicioni, megjithatë, nuk ka të drejtë që ta legalizojnë një veprim të këtillë. Së këndejmi, Partia Reformiste ORA ia dërgoi një letër Zv. PSSP-së Steven Shukut, duke kërkuar nga UNMIK-u anulimin e vendimit të Kuvendit. Që nga viti i shkuar, ORA ka kundërshtuar vazhdimisht vendimin e Kuvendit për ndërtimin e kësaj qendre në Gërmi, që është marrë në kohën kur kryetar i Kuvendit ishte Nexhat Daci, me arsyetimin se janë shkelur procedurat e prokurimit dhe se ky është një harxhim i panevojshëm i buxhetit të Kosovës.

Përmbushja e standardeve prioritare të përcaktuara nga Grupi i Kontaktit

Gjatë këtyre muajve, Kuvendi është angazhuar dhe ka punuar aktivisht rreth përmbushjes së trembëdhjetë standardeve prioritare, të përcaktuara në muajin qershor nga Grupi i Kontaktit. Është emëruar drejtori i Agjencisë Anti-Korrupsion të themeluar kohë më parë dhe njëherësh janë mbështetur të gjithë anëtarët e Këshillit të Komisionit të Mediave të Pavarura. Veç këtyre, Kuvendi e ka përmbushur edhe pjesën e vetë të obligimeve rreth procesit të emërimit të Ombudspersonit, duke miratuar Rregulloren e Punës. Ndërsa, sa i takon tri pjesëve të legjislacionit të përfshira në listën e prioriteteve të Grupit të Kontaktit, Ligji mbi liritë fetare është miratuar, kurse Ligji mbi trashëgiminë kulturore ka kaluar në shqyrtimin e parë. Po ashtu Ligji për përdorimin e gjuhëve është miratuar, por tani është duke u kontestuar nga përfaqësuesit e komunitetit turk.

Mocioni i komuniteti turk rreth Draft ligjit për përdorimin e gjuhëve

Në seancën plenare të 27 korrikut, Kuvendi i Kosovës miratoi Draft ligjin për gjuhët. Mirëpo, me këtë rast një amanda-

ment që kishte për qëllim përmirësimin e pozitës së komunitetit turk u refuzua. Sipas amandamentit: “Në ato komuna ku një komunitet, gjuha zyrtare e të cillit nuk është njëra nga gjuhët zyrtare të Kosovës, është i përfaqësuar me jo më pak se 5 % të popullatës së komunës, atëherë gjuha e atij komuniteti do ta ketë statusin e gjuhës zyrtare (...), ndaj, gjuha turke do ta ketë statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit”. Një refuzim i këtillë ishte mjaft befasues, ngase amandamenti ishte rezultat i një marrëveshjeje midis qeverisë dhe partisë turke, që është pjesë e koalicionit qeverisës. Së këndejmi, grupi parlamentar 6+, që përbëhet nga turqit dhe boshnjakët, duke u thirrur në Kornizë Kushtetuese, e kontestuan ligjin, ngaqë komuniteti turk konsideron se është fjala për interesat vitale të komunitetit të tyre. Me 2 gusht Kryeministri Çeku, Kryetari i Kuvendit Kryetari i partisë turke nënshkruan një marrëveshje, duke rikonfirmuar qëndrimin e tyre për përkrahjen e amandamentit të refuzuar. Megjithatë, me 25 gusht Kryesia e Kuvendit nuk e përkrahu këtë propozim të arritur me konsensus. Prandaj, meqë tash duhet së pari të themelohet paneli dhe më pas të dorëzohen rekomandimet e tij në seancë plenare, Draft ligji për përdorimin e gjuhëve nuk mund t’i dërgohet PSSP-së për shpallje. Kështu që, kjo kërkesë nga lista e standardeve prioritare e përcaktuar nga Grupi i Kontaktit akoma nuk është përmbushur.

Kuvendi shqyrton rolin e tij në procesin kushtetues

Gjatë korrikut u mbajtën një sërë takimesh që kishin në themel të vëmendjes adresimin e çështjes së procesit të hartimit të kushtetutës dhe rolin që do të ketë Kuvendi në të ardhmen lidhur me këtë çështje. Me këtë rast, Komisioni i Kuvendit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese diskutoi rreth një propozimi, ndërkaq kryesuesi i grupit parlamentar të AAK-së parashtroi kërkesën për organizimin e një debati në seancë plenare për hartimin e Kushtetutës. Sipas Kryesisë së Kuvendit, nevojitet më tepër kohë dhe koordinim në mënyrë që të mund të shqyrtohet dhe përcaktohet më saktë roli i Kuvendit dhe i afateve kohore për procesin e hartimit të Kushtetutës.

Sekretari i ri i Kuvendit

Pas një procedure gjithëpërfshirëse rekrutuese, Kryesia e Kuvendit përzgjedhi z. Ismet Krasniqin për Sekretar të ri të Kuvendit. Z. Ismet Krasniqi ka lindur me 10 qershor 1958 në Negrovç, të Glllogocit. Ka diplomuar për drejtësi në vitin 1980. Që nga viti 1984 ai ka mbajtur poste të ndryshme në Asociacion e Kooperativave Bujqësore të Kosovës, por kryesisht ka punuar si sekretar. Në detyrën e tij të re si Sekretar i Kuvendit, z. Krasniqi konsideron se prioritetet kryesore janë profesionalizmi i stafit të Kuvendit, sigurimi i shërbimeve teknike cilësore dhe administrata efikase, si dhe koordinimi i punës me organizatat që e mbështesin Kuvendin.

Institucioni i Ombudspersonit publikon raportin e gjatë vjetor (2005-2006)

Me 11 korrik, Institucioni i Ombudspersonit publikoi Reportin e gjashtë vjetor (2005-2006), i cili për herë të parë do t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës më parë se sa gjer më tani Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve.

Ky raport që përfshinë periudhën prej 1 qershorit 2005 deri me 30 qershor 2006, dhe shënon vitin kur Institucioni i Ombudspersonit po hyn në fazën e kosovarizimit të tërësishëm të tij. Për shkak të transferimit të udhëheqjes së këtij institucioni nga një Ombudsperson ndërkombëtar në atë vendor, mandati i institucionit është modifikuar përmes Rregullores së UNMIK-ut (2006/06) të shpallur në muajin shkurt. Ndërkaq, Kuvendi i Kosovës tani është në proces të rekrutimit të Ombudspersonit të ri dhe të hartimit të Li-gjit mbi Institucionin e Ombudspersonit.

Raporti vjetor jep vlerësimin e situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë nga perspektiva e kryesit të detyrës së Ombudspersonit, z. Hilmi Zhitia. Njëherësh ky raport merret edhe me mandatin, aktivitetet dhe perspektivën e ardhshme të këtij Institucioni.

Ndonëse është në fazën e tranzicionit, z. Jashari vuri në dukje se "Ky Institucion, megjithatë, vazhdon të merret me adresimin e problemeve të përditshme të qytetarëve." Gjatë fazës së raportimit, më shumë se 4000 qytetarë kanë ushtruar ankesa apo kanë

kërkuar këshilla zyrtare pranë këtij Institucioni, ndërsa zyrat qendrore dhe ato në terren të këtij institucioni kanë qenë nikoqire të 78 Ditëve të Hapura.

"Mungesa e përgjegjësisë së administratës publike, mbrojtja e pamjaftueshme e të drejtave të njeriut, mungesa e sistemit të duhur të sigurimit social, korrupsioni, nepotizmi dhe krimi i organizuar janë

faktorët kryesorë që kanë ndikuar në propagandimin e një sistemi të paqëndrueshëm legal për qytetarët, pohoi Jashari. "Këta faktorë janë bërë pengesë për funksionimin e duhur si të autoriteteve për zbatimin e ligjit ashtu edhe të gjyqësorit." Raporti po ashtu ngrit shqetësimet lidhur me lënien anash të drejtave të njeriut gjatë bisedave, mjaft të ngarkuara politikisht, mbi

statusin e ardhshëm të Kosovës.

Së këndejmi, me këtë rast z. Jashari u bëri thirrje politikkbërësve, udhëheqësve qeveritarë si dhe zyrtarëve publikë që të vazhdojnë me përkrahjen e Institucionit të Ombudspersonit dhe që të angazhohen që mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut të Kosovës bëhen në mënyrë të mirfilltë.

Çka është Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë?

Institucioni i Ombudspersonit është themeluar me Rregulloren numër 2000/38, dhe është një institucion i pavarur, i cili merret me adresimin e pretendimit për shkeljen e të drejtave njerëzore apo abuzimin e pushtetit nga ana e individëve/ grupeve të individëve/ personave juridik dhe Administratës së Përkohshme Civile në Kosovë. Ai/ajo pranon ankesat, inicion hetime dhe monitoron politikën dhe ligjet e miratuara nga autoritetet për të siguruar që ato janë në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut dhe të qeverisjes së mirë. Kështu që, përmes punës së tij ky institucion ndihmon në promovimin e të drejtave të njeriut dhe qeverisjes së mirë.

Kush është Ombudspersoni i Kosovës?

Ombudspersoni në Kosovë është një person i paanshëm dhe i mirënjohur në qarqe ndërkombëtare për karakterin dhe moralin e tij të lartë dhe angazhimin e tij për mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Ai/ ajo emërohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP-ja i KB-ve). Ai i ka dy zëvendës. Ndërkaq, këshilltarët ligjor, hetuesit dhe administratorët janë stafi i cili mbështetë punën e tij.

Kur është themeluar institucioni i parë i Ombudspersonit?

Institucioni i parë i Ombudspersonit në botë është themeluar në Suedi në vitin 1809. Në suedishte "ombudspersoni" është personi i cili mbikëqyrë zbatimin e ligjit nga ana e autoriteteve. Shumë vende kanë përvetësuar modele të ngjashme, duke përdorur emra të ndryshëm për këtë institucion, si fjala vjen Avokati i Popullit, Ndërmjetësi Publik, etj. Ndërkaq, kohëve të fundit institucione të Ombudspersonit janë themeluar në të gjitha vendet e botës, përfshirë Bosnje Hercegovinën, Hungarinë, Irlandën, Poloninë, Slloveninë, Spanjën dhe vendet e Amerikës Latine.

Përse është i rëndësishëm Institucioni i Ombudspersonit për Administratën e Përkohshme Civile?

Detyrat kryesore të administratës civile janë respektimi i të drejtave njerëzore dhe sigurimi i qeverisjes së mirë. Kjo faktori në mënyrë të drejtpërdrejt për efikasitetin dhe respektimin e standardeve të larta profesionale nga ana e tij. Duhet theksuar se Institucioni i Ombudspersonit nuk është kundër administratës, por angazhohet për qeverisje të mirë dhe për respektimin e të drejtave të njeriut. Së këtejmi, Ombudspersoni kontribuon në krijimin e administratës transparente dhe të hapur ndaj publikut.

Zgjedhjet po afrohen

Çad Roxhers është Drejtor vendor i NDI në Kosovë.

Ende nuk dihet saktësisht se kur do të përgatitet dhe çfarë do të përmbajë korniza ligjore, por e dimë se zgjedhjet në Kosovë po afrohen dhe se ato sipas të gjitha gjasave do të mbahen brenda 12 deri në 18 muajt e ardhshëm, si në nivelin lokal ashtu edhe në nivelin qendror.

Ndonëse kjo mund të tingëllojë për të gjitha partitë politike, organizatat civile dhe mediat si një deklaratë e rëndomtë, megjithatë është me rëndësi që të kihet parasysh se ambienti politik pëson ndryshime shumë të mëdha gjatë periudhës paraelektorale.

Kështu, fjalët që dëgjohen para fillimit të zgjedhjeve në media kanë të bëjnë me përpjekje më të mëdha rreth organizimit më të mirë të partive dhe përsheptimit të politikave zhvillimore. Ndërkaq, më pas gjatë javëve në vijim fillon gara për rekrutimin e anëtarëve të ri, për forcimin e degëve të partisë dhe identifikimin e

çështjeve të rëndësishme për votuesit.

Në trajnimet e organizuara nga NDI-ja, zakonisht në themelin e vëmendjes sonë janë katër elemente kryesore të organizimit politik: njerëzit, paratë, idetë dhe koha. Ndërkaq, shpeshherë sikur harrohet se koha është aset strategjik, që i vihet në dispozicion, në mënyrë të barabartë, të gjithë atyre që marrin pjesë në zgjedhje, por që shfrytëzohet vetëm nga disa pjesëmarrës në fushatë kundër oponentëve të tyre.

Si e shfrytëzon partia kohën për të arritur avantazh? Nëse do të duhej t'i rekrutoni 50 anëtarë të ri një javë para zgjedhjeve, në një kohë kur të njëjtën gjë përpiqet ta bëjnë edhe çdo parti tjetër, me këtë rast ju mbase do t'ia dilni mbanë që ta kryeni detyrën, por sipas gjasës me shumë shpenzime dhe vështirësi. Tani, paramendoni që të njëjtën detyrën duhet ta kryeni për 50

javë. S'do mend se ju jo vetëm që do të rekrutoni anëtarë të ri, por sipas të gjitha gjasave ca nga ata që do t'i rekrutoni do të krijojnë marrëdhënie aq të afërta dhe të mira me partinë sa që do të fillojnë edhe vetë të rekrutojnë anëtarë të ri për partinë. Kështu që rritja e numrit të anëtarëve është vetëm një ilustrim se si mund të shfrytëzohet maksimalisht periudha paraelektorale.

Me pak fjalë, për ta shfrytëzuar kohën si duhet në politikë, ju duhet të keni një plan. Planifikimi i fushatës është një gjë mjaft e thjeshtë, ju duhet ta kalkuloni numrin e votave që ju besoni se duhet t'i fitoni, dhe ti ndani ato në mënyrë proporcionale bazuar në historinë e votimit në secilin komunë votuese. Pastaj, hartoni një listë të shkurtër të çështjeve që do t'ua prezantoni simbeshtetësve tuajashu edhe atyre që mund të votojnë për ju, ashtu që ta arrini qëllimin sa i takon numrit të votuesve.

Problemi më i madh është përgjithësisht e çështjeve të drejta, përcaktimi i objektivave reale dhe ruajtja e disiplinës me qëllim të arritjes së të gjitha qëllimeve të përcaktuara për 12 deri në 18 muajt e ardhshëm. Secili kandidat, që garon, ankohet herët a vonë tek ekipi i fushatës së tij për atë se sa janë lodhur, duke i përsëritur gjërat e njëjta, sqaruar idetë e njëjta si dhe duke debatuar për çështje dhe tema të njëjta.

Përse përsëriten gjërat? Më tepër se 1 milion votues kanë të drejtë vote në zgjedhjet e ardhshme, dhe secili syresh shkon jetë të ndryshme dhe është mjaft i zënë me punë. Ndaj ata nuk mund t'i ndjekin të gjitha intervistat në televizion, apo në gazetë, apo mbase t'i shohin të gjitha stendat e afishimit (billboardat), apo një broshurat. Së këndejmi, kërkohet një angazhim dhe impenjim i vazhdueshëm përmes mediave me qëllim që fushata juaj të mund të ndiqet nga të gjithë qytetarët që votojnë.

Ndonëse, partitë dhe kandidatët shpeshherë pohojnë se është herët të fillohet me planifikim e fushatës së ardhshme, megjithatë ne e shohim të udhës që lidhur me këtë t'i japim pesë këshilla të dobishme që duhet të ndiqen:

1. Caktoni një organizator të fushatës

Ai person mund të jetë, por nuk është e thënë që të jetë drejtues i fushatës suaj. Detyra e tij/ saj është që të fillojë përgatitjet për zgjedhje në partinë dhe grupin tuaj parlamentar. Kjo do të thotë



që partia do të riaktivizohet rreth arritjes së rezultateve sa më të mira zgjedhore, dhe ndërsa të gjithë të tjerët vazhdojnë të merren me punët dhe aktivitetet e tjera të përditshme brenda partisë, së paku një person angazhohet kryesisht rreth fushatës së ardhshme.

2. Krijoni një buxhet

Ju duhet ta keni të qartë se sa para dëshironi t'i harxhoni para se të filloni me grumbullimin e parave. Pa dyshim se gjërat si shtypi, reklama dhe organizimi i ngjarjeve publike janë të kushtueshme. Së këtejmi, është mirë që fillimisht ta shikoni buxhetin për fushatën e fundit në mënyrë që të kuptoni se cilat shpenzime kanë pësuar ndryshime në treg. Veç kësaj, bisedoni edhe me zyrtarë të partisë dhe të fushatës për të vlerësuar se cilat shpenzime të bëra për fushatë kanë sjellë rezultate dhe cilat jo.

3. Bëni hulumtime

Hulumtimi mund të bëhet në formë të një analize (kuantitative), apo të fokusohet në një grup (kualitative), por qëllimi i saj duhet të jetë hulumtimi rreth qëndrimit të publikut ndaj liderëve, partive, çështjeve kryesore (p.sh, prioritetet e shpenzimeve të qeverisë) dhe atmosferës. Opinioni i gjerë publik, për të cilin të gjithë kujtojmë se e njohim, në të vërtetë ai rëndom është shumë para nesh. Prandaj, partitë të cilat e hetojnë se cilat janë çështjet me të cilat do të preokupohen qytetarët krahasuar me partitë që merren vetëm me çështje aktuale dhe të zakonshme,

do të jenë më mirë të përgatitura për fushatën (fushatat) e ardhshme.

4. Vlerësoni partinë tuaj

Suksesi në zgjedhje varet nga numri i votave të fituara, e jo nga qëllimi i angazhimit të vullnetarëve tanë. Së këndejmi, duhet që patjetër të shohim se kush në parti dhe në degët e partisë nuk është duke punuar si duhet dhe kush është duke punuar shumë mirë. Ne duhet të bëjmë vlerësimin e numrit aktual të anëtarësisë, aktiviteteve dhe fondeve që duhet të sigurohen si dhe të shohim se cilat degë kanë kapacitet për përbushjen e objektivave të përcaktuara. Po kështu, është me rëndësi që të shohim se cilat degë kanë kapacitete të tepërta- ashtu që ato degë që kanë burime të tepërta t'i rishpërndajnë burimet dhe kapacitetet e tyre me qëllim që ato të shfrytëzohen sa më me efikasitet brenda partisë.

5. Trokitni nëpër dyer

Votuesit mund t'ju ndjekin në televizion, t'ju shohin në Kuvend dhe mbase të lexojnë për ju në gazetë, por ajo që ata vërtetë e çmojnë është kontakti personal. Së këtejmi, e gjithë partia duhet të fillojë të trokasë nëpër dyer, për t'i dëgjuar ankesat, idetë dhe dëshirat e qytetarëve. Nuk është e thënë që të gjitha problemet t'i zgjidhni menjëherë, por është me rëndësi që votuesit të ndjejnë se i keni respektuar, duke i kontaktuar drejtpërdrejt personalisht. Ne duam që çdo votues ta dijë se ne i dëgjojmë, i kuptojmë dhe interesohemi për brengat dhe hallet e tyre.

Dhe fare në fund, s'duhet harruar se ka mjaft gjëra që nuk i dimë lidhur me zgjedhjet e ardhshme.

Prandaj, si parti politike keni mjaft gjëra për të cilat mund të filloni të merrni shënime, të përcaktoheni dhe të planifikoni.

S'ka pikë dyshimi se Instituti Nacional Demokratik do të jetë i gatshëm që t'ju ndihmojë rreth planifikimit si dhe t'i asistojë kandidatët për të filluar me përgatitjen rreth planeve për fushatë për vitin e ardhshëm.

Së këndejmi, gjatë gjithë vjeshtës në themel të vëmendjes sonë do të jenë trajnimet rreth hartimit të platformës, organizimit të partisë dhe vazhdimi i punës rreth "Akademisë së Trajnimit të Partive" që është dëshmuar mjaft e suksesshme dhe që u ka ardhur në ndihmë partive për të trajnuar një kuadër aktivistësh me përvojë dhe të informuar mirë.

Kur të uleni për të menduar rreth draftit të parë të planit të fushatës, përpiquni të mendoni për zgjedhjet e ardhshme sikur të ishte fjala për një intervistë për punë. Gjëja më e vështirë me këtë rast është që të kuptojmë se cilat janë kualifikimet që kërkohen për këtë vend pune apo edhe specifikat e kësaj pune.... ndaj, ne duhet të mendojmë se cilat mund të jenë ato, me fjalë të tjera duhet të dalim me vizionin e partisë sonë për të ardhmen e Kosovës dhe ta prezantojmë atë me besim, vendosmëri dhe sa më shpesh.

Roxhers u ka ofruar udhëzime dhe ka shërbyer si këshilltarë i aktivistëve të partive politike nga Armenia, Bosnja dhe Hercegovina, Iraku, Kosova, Kirgistani, Maqedonia dhe Moldavia.

Vijon nga fq. 15

në të ardhmen. Objektiva e përbashkët e BE-së dhe Kosovës është që të siguroj, që Kosova të bëhet një partnere e besueshme, duke ecur drejt integritet të bashku me pjesën tjetër të Ballkanit perëndimor. E rëndësishme për integrimin evropian dhe për të qenë partner i besueshëm i tij është reforma fiskale dhe zbatimi i legjisllacionin për mbrojtjen e investitorëve të huaj. Të gjitha këto do ta mbështesin realizueshmërinë e politike dhe ekonomike.

Por neve na duhet më shumë se mbrojtja e ekonomisë, tregut dhe investimit. Integrimi evropian nënkupton edhe zbatimin e standardeve evropiane në arsim, shëndetësi dhe çështjet për punë dhe mirëqenie sociale. Vazhdon!

Sqarim: Ky artikull, jodomsdoshmërisht, paraqet pikëpamjet e projektit të financuar nga BE-ja 'Mbështetja e mëtutjeshme për Kuvendin e Kosovës', menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim dhe Zbatuar nga Konzorciumi i Kuvendeve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës dhe Sllovenisë si dhe Instituti ndërkombëtar për mbrojtje i Parisit dhe në asnjë mënyrë nuk i parashihet aktivitetet dhe politikat në këtë hapësirë. Përmbajtja e kësaj është në përgjegjësi të vetë autorit. Informacionet e përfshira në këtë dokument, përfshirë edhe shprehjen e pikëpamjeve dhe çdo projekcion ose parashikim është marrë ose bazuar në burimet e besuara nga autori, por nuk garanton për sa i përket saktësisë apo kompletimit. Informacioni është dhënë pa ndonjë obligim, duke lënë të kuptohet se kushdo që përmirëson diçka apo e ndryshon qëndrimin e tij/saj rreth kësaj, atëherë këtë e bënë plotësisht në rrezik të vetin.

Praktikantët organizojnë konferenca për grupet parlamentare në lidhje me çështjet e politikave

Labinot Hoxha, Misioni i OSBE-së në Kosovë



Në një ambient ngazëllues dhe të organizuar mirë, një dhomë takimesh me 40-50 pjesëmarrës të etur për të dëgjuar dhe kontribuar, morën pjesë në diskutimet ngashënjese, të cilat përfunduan me rekomandime të qarta për zhvillimet e më tutjeshme. Kjo është çfarë mund të shihje, gjatë muajit qershor të këtij viti në Kuvendin e Kosovës, si kurrë më parë. Kjo ishte një pasqyrë e përgjithshme e konferencave të shoshitura mirë nga grupet parlamentare të Kuvendit.

Sipas pjesëmarrësve, pasi që kanë qenë të ftuar me kohë, të pajisur me informata të nevojshme dhe me prezencë të ekspertëve të shquar lokal dhe rajonal, iu është bërë më e lehtë për t'u angazhuar dhe për të dhënë kontributin e tyre. Ky rezultat iu është komunikuar mediave në mënyrë efikase, të cilat pastaj e kanë përcjellë informacionin tek publiku i gjerë. Kjo e ka qartësuar qëndrimin e grupeve parlamentare në lidhje me një numër çështjesh të politikave, i ka përshkruar angazhimet e tyre të ardhshme, si dhe ka parashikuar orientimin e

këtyre grupeve për t'u marrë me këto çështje.

Konferencat janë organizuar nga të rinjtë, të cilët vijonin programin gjashtëmujor për praktikantë, të mundësuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Përveç mbështetjes financiare, misioni i OSBE-së ka organizuar trajnime të posaçme për t'u mundësuar ta kryejnë detyrën e tyre më të rëndësishme, gjatë gjithë kohës në Kuvend. Kurset janë udhëhequr në bashkëpunim të ngushtë me shefat e gjashtë grupeve parlamentare (të LDK-së, PDK-së, AAK-së, ORA, 6+ dhe SLKM-së) si dhe me DP-të. Grupi parlamentar 'Për integrim' nuk ka marrë pjesë në program, meqë kur ka filluar programi, ky grup parlamentar nuk ekzistonte atëbotë. Por, ky grup mund të përfshihet në vazhdimin e ndonjë programi për praktikantë.

OSBE-ja ka nisur zbatimin e programit për praktikantë, për Kuvendin e Kosovës në mes të vitit 2005 dhe ky projekt ka vazhduar edhe gjatë vitit 2006. Në program

janë regjistruar 23 praktikantë me kontrata gjashtë mujore. Praktikantët janë zgjedhur dhe vendosur në zyrat e grupeve parlamentare. Kanë qenë të angazhuar me punë të përditshme në zyre, duke i ofruar mbështetje kryesuesve të grupeve parlamentare. Praktikantët gjatë trajnimit dhe udhëzimeve fituan njohuri për ngritjen e bashkëpunimit të brendshëm me qëllim të rritjes së kapacitetit të grupeve parlamentare në Kuvend për zhvillimin e politikave koherente dhe krijimin e një profili parlamentar.

Grupet parlamentare LDK-ja dhe ORA i kanë organizuar ndarazi konferencat për çështjet e rinisë dhe janë përqendruar kryesisht në zbatimin e Planit të Veprimit të Rinisë në Kosovë (PVRK). Personat e angazhuar në hartimin dhe krijimin e PVRK-së iu shpjeguan pjesëmarrësve përfitimet kryesore potenciale të zbatimit të saj dhe u bënë thirrje për mbështetje përfaqësuesve të organeve ligjvënëse. Grupi parlamentar i PDK-së u përqendrua në

"Energji dhe Privatizim", duke dalë me rekomandime për vazhdimësinë e aktiviteteve, me qëllim të rritjes së potencialit prodhues të energjisë në Kosovë, duke i shtuar sugjerimet e tyre për politikat e reja. Grupi parlamentar i AAK-së e përqendroi konferencën mbi "Stimulimin e produkteve bujqësore të vendit" dhe i mblodhi prodhuesit bujqësor kryesor dhe institucionet. Këta përvijuan politikat, që ndikojnë në prodhimtarinë bujqësore dhe plasimin e tyre në tregun kosovar dhe atë rajonal. Në konferencë ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e institucioneve evropiane të cilët ia shtuan dimensionin evropian kësaj konference.

Grupi parlamentar 6+ u përqendrua mbi "Arsimin në gjuhën turke dhe boshnjake në Kosovë", duke i kushtuar vëmendje vështirësive në shkollim, me të cilat përballen këto dy komunitete dhe duke filluar nga nevojat elementare për furnizimin me tekste shkollore dhe material tjetër arsimor në gjuhën e tyre. Grupi i SLKM-së organizoi konferencë mbi "Po-zitën e komunitetit serb në institucionet e Kosovës" që do të mbahet nga fundi i këtij viti.

Përveç ndihmës së dhënë grupeve parlamentare, programi për praktikantë u ofroi pjesëmarrësve mundësinë për të kuptuar punën e Kuvendit. Në fund, nëse jo më gjatë, suksesi i programit garanton vazhdimësinë e tij në të ardhmen e afërt.



Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respek-timin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgje-gjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevojat në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinatori i ASI-t Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregullt i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Sven Lindholm, Franklin De Vrieze, Skender Durmishi, Blerim Vela, Alfons Lentze, Chris Cycmanick, Ramë Manaj, Edmond Efendija, Krenar Loshi, Mahir Shehu, Labinot Hoxha.

Grafika dhe faqosja: Shpend Kada

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij bulletini :

OSBE-ja: 5, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 23. Express: Astrit Ibrahim: 1, 2, 7, Fisnik Dobreci: 3, 10. Ermal Meta: 4. Chad Rogers: 21.